

il gusto di un grande caffè



ECSRA

Fuqizimi i Shoqërisë Civile në Zonat Rurale

Libri i arritjeve





ECSRA

Fuqizimi i Shoqërisë Civile në Zonat Rurale

Libri i arritjeve



Empowered lives.
Resilient nations.



Përmbajtja

I. Rreth projektit ECSRA	7
1.1 Konteksti dhe objektivat e projektit	7
1.2 Veprimtaria e projektit	8
1.3 Procesi	9
1.4 Aktorë dhe mbështetësit e iniciativës.....	10
II. Konteksti i zonave të targetuara dhe strategjia e ECSRA	11
2.1 Konteksti socio-ekonomik i zonave të targetuara	11
Berati	11
Elbasani	12
Gjirokastra	13
Lezha	14
2.2 Grupet e synuara dhe përfituesit	16
2.2.a Fokusi tek zonat rurale dhe periferike	16
2.2.b Sfida për fuqizimin e qytetarëve dhe inkurajimin e qeverisjes së mirë	17
2.3 Strategjia e ndërhyrjes dhe përqasja metodologjike e ECSRA	18
2.3.a Komponenti i vlerësimit dhe disenjimit të strategjisë së punës	18
2.3.b Komponenti i ndërtimit të kapaciteteve	20
2.3.c Komponenti i rritjes së ndërgjegjësimit dhe njohurive	22
2.3.d Komponenti i ndarjes së eksperiencave dhe advokimit	22

III. ECSRA: Zbatimi dhe impakti	25
3.1 Komponenti: Vlerësim dhe ndërtim strategjie	25
3.2 Komponenti: Ndërtimi i kapaciteteve	27
3.3 Komponenti: Informim dhe ndërgjegjësim	29
3.4 Komponenti: Ndarja e eksperiencave dhe advokimi	32
3.5 Dëshmi	33
IV. Partnerë për ndryshim: iniciativat e përbashkëta ECSRA dhe OShC të zonave rurale/periferike	37
4.1 Kuadri i nismave të përbashkëta	37
4.2 Aktivitetet e zbatuara dhe rezultatet e arritura:	39
4.3 Rezultate	48
V. ECSRA: Praktikrat më të mira	50
5.1 Revista komunitare	50
5.2 Panairi i lideve	51
5.3 Mbështetja me grante të vogla	53



RRETH PROJEKTIT ECSRA

1.1 Konteksti dhe objektivat e projektit

Pavarësisht progresit të dy dekadave të fundit, shoqëria civile shqiptare vazhdon të hasë vështirësi përsa i përket rritjes së ndikimit të saj në qeverisje, për të arritur tek qytetarët, si dhe për sigurimin e një ndikimi të qëndrueshëm të veprimtarive të saj. Indeksi i Shoqërisë Civile për Shqipërinë (IShC) i vitit 2010, si edhe raporte të tjera vlerësimi të sektorit të tretë mundësojnë evidencë empirike lidhur me mospërputhjet e niveleve të zhvillimit dhe rolit të shoqërisë civile në zonat urbane kundrejt rolit dhe zhvillimit të saj në zonat rurale dhe ato periferike.

Mungesa e aktorëve aktivë të shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike u mohon komuniteteve të këtyre zonave përfitimet e një qeverisjeje me pjesëmarrje dhe të orientuar drejt qytetarëve si edhe i privon ata nga avantazhet e procesit të integrit. Më konkretisht, shoqëria civile është një prej aktorëve kryesorë për të ardhmen e Grupeve Vendore të Veprimit për zhvillimin rural (Ang. LAG-s, një partneritet trepalësh ndërmjet shoqërisë civile, qeverisjes vendore, dhe sektorëve privatë) si struktura bazë nëpërmjet të cilave do të kanalizohet ndihma e BE-së për



Në një kontekst të tillë u ideua dhe më pas u implementua projekti “Fuqizimi i Shoqërisë Civile në Zonat Rurale dhe Periferike për Promovimin e Qeverisjes së Mirë dhe Zhvillim”, i njohur me akronimin ECSRA. Ai synoi të nxisë shoqërinë civile në zonat rurale dhe ato periferike, si edhe të kontribuojë për qeverisjen e mirë nëpërmjet ndërtimit të kapaciteteve dhe fuqizimit të shoqërisë civile në këto zona. Nisma u përpoq të stimulojë aksionin e shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike si edhe të promovojë qeverisjen e mirë dhe përfshirjen qytetare në zonat më të paavantazuara dhe periferike të Shqipërisë duke lehtësuar dhe nxitur bashkëpunimin dhe partneritetin e ngushtë ndërmjet sektorit civil, autoriteteve vendore dhe rajonale, dhe partnerëve të tjerë vendorë.

Iniciativa u shtri në katër qarqe – Berat, Elbasan, Lezhë dhe Gjirokastrë në një hark kohor prej 18 muajsh (korrik 2011 – dhjetor 2012) dhe trajtoi shqetësimet kryesore nëpërmjet përmbushjes së dy objektivave specifike:

1. Ndërtimi i kapaciteteve të qëndrueshme për shoqërinë civile në zonat rurale e periferike si një aktor kryesor dhe i pa-zëvendësueshëm për avancimin e prioritetëve të komuniteteve rurale nëpërmjet veprimesh konkrete që promovojnë përmbushjen e principeve demokratike bazë të një qeverisjeje përfshirëse, të përgjegjshme dhe të orientuar drejt qytetarit.

2. Rritja e ndërgjegjësimit dhe advokimi me aktorët kryesorë kombëtarë dhe vendorë për forcimin e shoqërisë civile, zhvillimin e alternativave për rritjen e ndikimit të sektorit të tretë në zonat rurale e periferike dhe për fuqizimin e ShCR-së dhe të aktorëve vendorë me synim përfshirjen e tyre në rrjete dhe partneritete trepalësh si një instrument efikas për trajtimin e pabarazive të zhvillimit dhe zhvillimin rural.

1.2 Veprimtaria e projektit

Projekti u implementua në disa faza, por që për nga natyra dhe qëllimi mund të kategorizohen sipas katër komponentëve kryesorë, paraqitur në vijim:

1.2.1 Komponenti i vlerësimit dhe disenjimit të strategjisë së punës:

Ky komponent u përmbush përmes aktiviteteve të ndërmarra dhe të realizuara në kuadër të:

- a. Veprimtarive përgatitore për inciimin dhe zbatimin e projektit;
- b. Realizimin e një studimi vlerësues për shoqërinë civile në zonat rurale dhe periferike në Shqipëri;
- c. Publikimi i buletinit informativ dhe përgatitja për fushatën ndërgjegjësuere.

1.2.2 Komponenti i ndërtimit të kapaciteteve:

Në kuadër të komponentit të dytë u ndërmorën aktivitete, impakti i të cilave do të rezultonte në rritje të kapaciteteve të aktorëve të shoqërisë civile në zonat

rurale dhe periferike të qarqeve të targetuara, por edhe ndërtimi i kapaciteteve të partnerëve të tyre nga sektori shtetëror dhe ai privat në nivel lokal.

Aktivitetet kryesore u fokusuan në:

- a. Ndarjen e gjetjeve të raportit vlerësues dhe rritjen e ndjeshmërisë mbi problematikat e identifikuar;
- b. Përgatitjen e manualeve mbi 'Menaxhimin e Organizatave të Shoqërisë Civile' si dhe mbi partneritetin Shoqëri Civile – Institucione Shtetërore – Biznes;
- c. Organizimin e trajnimeve për rritjen e kapaciteteve të OShC-ve në zonat rurale dhe periferike lidhur me ciklin e projektit dhe menaxhimin e OShC-ve;
- d. Organizimin e trajnimeve mbi bashkëpunimet trepalëshe me pjesëmarrje nga të tre sektorët: shoqëri civile, pushtet vendor dhe sektor privat.

1.2.3 Komponenti i rritjes së ndërgjegjësimit dhe njohurive

Ky komponent u karakterizua nga veprimtari informuese dhe ndërgjegjësuere. Pjesë e tyre ishin:

- a. Fushata ndërgjegjësuere në median elektronike;
- b. Shpërndarja e publikimeve të përgatitura në kuadër të iniciativës ku përfshiheshin fletëpalosje informative, seria e buletineve, manualët dhe raporti vlerësues për shoqërinë civile në zonat rurale dhe periferike.

1.2.4 Komponenti i ndarjes së eksperiencave dhe advokimit

Ndarja e eksperiencave dhe advokimi u realizua përmes:

- a. Workshopeve-ve
- b. Panairit të ideve
- c. Konferencave

Të gjitha këto aktivitete u realizuan me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të të tre palëve potenciale për partneritet dhe bashkëpunim: shoqëri civile, pushtet vendor dhe sektor privat.

1.3 Procesi

Në përfundim të implementimit të projektit ECSRA reflektimet mbi ecurinë e tij dhe procesin e ndjekur hap pas hapi janë pozitive. Procesi i implementimit të projektit ndoqi me korrektësinë e nevojshme fazat dhe komponentët e planifikuar në funksion të realizimit të objektivave dhe qëllimeve të tij. Nga ana tjetër, ai tregoi elasticitetin e nevojshëm për të lehtësuar dhe mundësuar një akses sa më të gjerë të përfituesve të tij me konsideratë natyrën e ndërhyrjes dhe targetin e saj.

Procesi i implementimit të iniciativës u dizajnuar sipas disa fazave të cilat në mënyrë integrale respektonin komponentët e përshkruar në seksionin e mëpar-

shëm. Ndonëse disa elementë, si përshembull elementët informues dhe ndërgjegjësuere, e kanë përshkruar të gjithë procesin, fazat kryesore të tij janë dominuar nga aktivitete dhe përjasje specifike për plotësimin e komponentëve kryesorë të iniciativës: vlerësim nevojash – ndërtim kapacitetesh – informim dhe ndërgjegjësim – ndarje eksperiencash dhe advokim.

1.4 Aktorët dhe mbështetësit e iniciativës

Implementimi i projektit brenda afateve të parashikuara dhe në përputhje me rezultatet e pritshme u mundësua ndër të tjera edhe nga përfshirja, kontributi dhe mbështetja që aktorë të ndryshëm në nivel vendor ofruan përgjatë gjithë fazave të implementimit. Mbështetja e iniciativës ishte trepalëshe – nga shoqëria civile, pushteti vendor dhe biznesi.

Projekti gjeti entuziazmin dhe mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile që operonin në zonat rurale dhe periferike të qarqeve Berat, Lezhë, Elbasan dhe Gjirokastrë. Në implementimin e projektit u përfshinë organizata joqeveritare si dhe shoqata dhe unione fermerësh me interesa dhe aktivitet në zonat e targetuara.

Përfaqësues të biznesit dhe dhomave të tregtisë në qarqet ku projekti gjeti zbatim u bënë jo vetëm mbështetës të iniciativës, por edhe pjesëmarrës aktivë dhe promovues të aktiviteteve të saj. Ata treguan interes dhe gatishmëri për bashkëpunime të mëtejshme.

Iniciativa u mirëprit dhe gjeti mbështetjen e plotë të organeve të pushtetit vendor. Bashkitë e qyteteve të përfshira në qarqet Berat, Lezhë, Elbasan dhe Gjirokastrë u kthyen në partnerë të rëndësishëm të implementimit të iniciativës duke ofruar mbështetje deri në nivelet më të larta – kryetarësh dhe këshillash bashkiak.

Së fundi, por jo për nga rëndësia, mbështetës dhe promovues i rëndësishëm i iniciativës ishte edhe media. Mediat lokale luajtën një rol parësor dhe të pazëvendësueshëm veçanërisht në arritjen e objektivave informues dhe ndërgjegjësuere.

KONTEKSTI I ZONAVE TË TARGETUARA NGA PROJEKTI (4 QARQET) DHE STRATEGJIA E “ECSRA”

2.1 Konteksti social-ekonomik i zonave të targetuara

Berati

Qarku i Beratit shtrihet në një sipërfaqe prej 1.798 km² në krahinën Malore Qendrore e pjesërisht në Ultësirën Jugperëndimore të Shqipërisë. Popullsia e qarkut Berat llogaritet rreth 113.619 banorë. Qarku përbëhet nga rrethi i Kuçovës, Skraparit dhe ai i Beratit. Qytetet kryesore janë Kuçova, Poliçani, Ura Vajgurore, Çorovoda e Bogova. Rreth 45.5 % e popullsisë jeton në zonat urbane në një kohë që qarku ka një moshë mesatare 36 vjeç. Të ardhurat mujore mesatare në vitin 2007 sipas INSTAT-it ishin rreth 31.000 lekë për familje, më e ulët se 38.000 lekë/muaj që është mesatarja kombëtare, ndërkohë papunësia dhe varfëria janë dy sfidat kryesore të zhvillimit të qarkut.

Kryesisht Qarku Berat shtrihet në një territor me reliev malor e kodrinor, me lartësi mesatare mbi nivelin e detit 455 m. Fushat shtrihen në krahun veri-perëndimor, në luginën e Osunit, derisa bashkohet me fushën e Myzeqesë. Në mjedisin natyror të Beratit dallohen: zona fushore e kodrinore e Beratit dhe e Kuçovës, mali i Tomorit (lindje, 2.417 m) dhe ai i Shpiragut (Perëndim, 1.218 m) si edhe lugina e Osunit dhe e Tomoricës. Zona fushore dhe ajo kodrinore janë baza e zhvillimit të prodhimeve bujqësore, ndërsa malet dhe luginat përfaqësojnë burime të mëdha pyjore, kullota dhe burime hidrike, ende të pashfrytëzuara si potenciale të rëndësishme të zhvillimit ekonomik e mjedisor. Në malin e Tomorit, qysh nga viti 1996, një zonë prej 4.000 Ha është shpallur Park Kombëtar. Për nga numri i vizitorëve ai renditet i dyti në vend, pas Parkut Kombëtar të Dajtit.

Pozicioni gjeografik favorizon transportin edhe komunikimin ekonomik-shoqëror me shumë rrethe të vendit. Megjithatë ndërtimi i segmenteve të tjerë rrugorë, sipas studimeve të ndryshme, do të përmirësonte komunikimet me zona të tjera, duke hapur mundësi për një zhvillim më të shpejtë dhe intensiv të Beratit. Lumi i Osunit, i cili rrjedh përmes qytetit është një nga lumenjtë kryesorë të vendit. Ai paraqet interes për bujqësinë, energjetikën, hidrogeologjinë, ekologjinë dhe urbanistikën.

Osumi transporton në Seman rreth 995 milionë m³ ujë në vit, me prurje mesatare 32,5 m³/sek.

Turizmi, përbën një nga drejtimet kryesore të zhvillimit ekonomik të Beratit. Qyteti trashëgon nga e kaluara vlera të shumta historike, kulturore, etnografike që përbëjnë një potencial të konsiderueshëm për turizmin. Me burimet turistike të qytetit është e mundur që të zhvillohet turizmi familjar dhe ai i organizuar.

Në vitin 1961 Berati u shpall zyrtarisht qytet muze. Me një pasuri të konsiderueshme monumentesh dhe me vlera të larmishme për nga gjinitë, të cilat përbëjnë një dëshmi të trashëgimisë kulturore, historike e artistike, të jetës e të punës, të realizuara mjeshhtërisht brez pas brezi nga banorët e tij. Që nga korriku 2008 Berati është pjesë e trashëgimisë kulturore botërore nën mbrojtjen e UNESCO-s. Sot Berati trashëgon 210 objekte muzeale, nga të cilat 150 janë objekte në këmbë. Prej tyre 60 janë monumente të kategorisë së parë dhe të tjerat të kategorisë së dytë. Vitet e fundit vërehet se komuniteti është ndërgjegjësuar në shkallë të ndjeshme për këto vlera, por nevojiten investime në veçanti në drejtim të restaurimit e ruajtjes së vlerave të trashëguara, në sigurimin e infrastrukturës së nevojshme urbane dhe në promovimin turistik të zonës.

Artizanati, si një vlerë e trashëguar, mbetet ende në zhvillim në shumë mjeshhtëri si: gdhendje në dru; qëndistari, punime ne argjend dhe në metale të tjera, punime në kashtë; gdhendje e punime dekorative në gur etj. Vitet e fundit vërehet një rigjallërim të këtyre mjeshhtërive.

Në fushën e agrikulturës, Berati është i mirënjohur për ullirin, fikun, vreshtarinë, fruta perimet, bimët medicinale, verën etj. Rrethi i Beratit ka burime të pasura dhe traditë në prodhimet bujqësore e blegtorale. Aktualisht llogariten rreth 6.000 ha plantacione në të gjithë rrethin kryesisht ullinj me një prodhim vjetor prej rreth 10.000 ton ullinj; fiq me një prodhim vjetor prej rreth 4.000 ton; dhe vreshta me një prodhim vjetor prej rreth 10.000 ton. Në rajonin e Beratit për shkak dhe të klimës shumë të favorshme kultivohen pothuajse të gjitha frutat e perimet e stinës.

Ndërkohë vitet e fundit është zhvilluar edhe industria e përpunimit të prodhimeve bujqësore. Në Berat ka një numër sipërmarrjesh agro-ushqimore që merren me përpunimin e fikut, ullirit, verës, pijeve alkoolike dhe perimeve e frutave të konservuara.

Duke marrë në konsideratë potencialet turistike, natyrore dhe prodhuese të zonës, Berati mbetet ende në përpjekje të zhvillimit ekonomik dhe rritjes së standardit të jetesës. Organizimet e fermerëve janë të pamjaftueshme dhe hallkat që duhej të lidhnin ata me përpunuesit e produkteve të tyre duke krijuar vështirësi si në prodhim dhe në shitjen e produkteve bujqësore.

Elbasani

Elbasani, i njohur ndryshe edhe si kërthiza e Shqipërisë, ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 3292 km². Kufizohet në veri dhe veriperëndim me qarkun e Tiranës, në lindje dhe juglindje me qarkun e Korçës, në perëndim dhe jugperëndim me

qarkun e Beratit. Në përbërje të tij janë katër rrethe: Rrethi Elbasan, që është edhe qendra e këtij qarku, rrethi Librazhd, rrethi Peqin dhe rrethi Gramsh. Administrativisht, qarku ka 7 bashki, 43 komuna dhe 386 fshatra.

Qarku i Elbasanit është qarku i tretë më i madh përsa i përket popullsisë pas Tiranës e Fierit dhe i treti për nga sipërfaqja pas Korçës dhe Shkodrës. Popullsia e qarkut është rreth 433.244 banorë. Rrethi i Elbasanit është edhe rrethi më i madh i qarkut, me popullsi mbi 20% më të madhe se popullsia e tre rretheve të tjera së bashku. Edhe pse vërehet një rënie e popullsisë me 6% për periudhën 2001-2008, dendësia e popullsisë në nivel qarku ka mbetur pothuajse e pandryshuar, madje është rritur veçanërisht në rrethin e Peqinit dhe të Elbasanit. Dendësia e popullsisë në 2008 ishte 107 banorë/ km² dhe pjesa që zë popullsia urbane mbi totalin e popullsisë në 2008 ishte 36% (nën mesataren kombëtare). Rajoni tregon një nivel mesatar zhvillimi përsa i përket aspekteve social-ekonomike dhe konkurruese.

Në qarkun e Elbasanit aktualisht mbizotëron popullsia fshatare, e cila përfaqëson rreth 65% të popullsisë totale, kundrejt 69% që ishte në vitin 1989. Rrethi i Elbasanit, pjesën e popullsisë rurale e ka më të ulët, afër 56%.

Klima e qarkut Elbasan karakterizohet nga një klimë mesdhetare, me dimër të butë dhe verë të nxehtë. Reshjet bien kryesisht në stinën e dimrit dhe të vjeshtës me një mesatare prej 1.490 mm në vit. Temperatura mesatare vjetore është 15.4°C.

Përsa i përket relievit 38% e përbëjnë malet, 28% e përbëjnë fushat dhe 34% e përbëjnë kodrat. Qarku përshkohet nga dy lumenj kryesorë: Shkumbini e Devolli. Arteria kryesore hidrografike e qarkut është lumi Shkumbin që rrjedh nga juglindja drejt perëndimit duke e ndarë rrethin e Elbasanit në dy pjesë të barabarta. Ka një sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës prej 1062 km² dhe gjatësi 90 km.

Në pasuritë hidrografike të qarkut të Elbasanit hyjnë edhe rezervuarët e liqenet. Rrethi i Elbasanit ka një sipërfaqe ujore rreth 650 ha të cilat përbëhen nga liqene natyrore dhe rezervuare të ndërtuar për qëllime vaditjeje. Përkatësisht rezervuarët zënë një sipërfaqe prej 342 ha dhe janë rreth 33 të tillë, ndërsa liqene janë 34 dhe zënë një sipërfaqe prej 310 ha kryesisht në zonën e Dumresë.

Zhvillimi rajonal i qarkut të Elbasanit, karakterizohet nga një bazë ekonomike e moderuar, por edhe me probleme të mëdha strukturore, duke përfshirë këtu dhe degradimin e zonës industriale. Potencialet për industrinë, bujqësinë dhe turizmin duket se janë mesatare, por me një tendencë në rritje dhe me pasoja pozitive në zhvillimin e rajonit. Të ardhurat mujore mesatare në qarkun e Elbasanit llogariten në vetëm 24.906 Lekë (2007), krahasimisht shumë më e ulët se mesatarja në nivel kombëtar (38.141 Lekë).

Fushat me mundësi zhvillimi nga partnerët rajonalë dhe lokalë të qarkut të Elbasanit, që pritet të ndikojnë në zhvillimin e shpejtë janë: zhvillimi hapësinor, ekonomik, shoqëror dhe rural. Në këtë kontekst, qarku i Elbasanit në të ardhmen synon promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm urban e rural, rritjen e rolit të qytetit

të Elbasanit si qendra administrative e rajonit me shërbime të standardizuara dhe aktivitete kulturore e sociale, mbrojtja dhe shtimi i pasurisë dhe burimeve natyrore, forcimi i kohezionit të komunitetit, rivitalizimi urban dhe rural, promovimi i një shpërndarjeje të balancuar të mundësive të zhvillimit ekonomik, një qasje e balancuar mbi infrastrukturën e telekomunikacionit për të krijuar një avantazh konkurrues etj.

Reduktimi i ndotjes nga zhvillimi industrial dhe menaxhimi i mbeturinave mbeten ende problematike në qarkun e Elbasanit. Vitet e fundit janë bërë përpjekje për mbështetje të aktiviteteve bujqësore dhe promovimi i produkteve bio në zonat specifike si dhe mbështetjen e komuniteteve rurale që jetojnë në vendbanime më të vogla.

Gjirokastra

Qarku i Gjirokastrës ka një sipërfaqe prej 2.884 km² duke përfshirë rrethin e Gjirokastrës, rrethin e Përmetit dhe rrethin e Tepelenës. Qarku i Gjirokastrës kufizohet në veri me qarkun e Beratit, në veriperëndim me qarkun e Fierit, në jug deri në perëndim me qarkun e Vlorës, në juglindje me Greqinë dhe në lindje me qarkun e Korçës. Qarku i Gjirokastrës ka një popullsi prej 58754 banorë.

Gjirokastra që prej vitit 2005 është përfshirë në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s, si një nga pak shembujt e mbijetuar në Ballkan të qyteteve tregtare të stilit otoman.

Në qarkun e Gjirokastrës rrjedh lumi Vjosa dhe në jug lumi Drino. Qendra e qarkut të Gjirokastrës ndodhet në qytetin e Gjirokastrës i vendosur në Shqipërinë jugore, qëndron në shpatet e pjerrëta të luginës së lumit Drino, në një pozicion mbisundues mbi një peizazh të pasur me histori, kufijtë e të cilit përvijohen nga maja malesh të larta.

Gjirokastra është një nga qendrat më të rëndësishme ekonomike në Jugun e Shqipërisë. Pika doganore e Kakavijës, është pika kufitare me fluksin më të madh të udhëtarëve dhe mallrave drejt Greqisë. Gjirokastra përveç të qenit qendër administrative e rajonit, ku kanë prezencën e tyre kompanitë të njohura prodhuese dhe tregtare të vendit duke përbërë edhe qendrën më të madhe bankare në jug të Shqipërisë.

Gjirokastra përfshin qindra shtëpi-kullë të tipit otoman me çatitë dalluese të gurta, ballkonet e drunjta dhe muret e gurta herë-herë të zbardhura me gëlqere. Gjirokastra, me kalanë madhështore që ngrihet mbi një kodër të thiktë, është një muze me mjaft tradita dhe kulturë. Nga bastion i feudalizmit në xhevahir otoman më pas në qendër e rëndësishme e pushtesve fashistë italianë, qyteti ka njohur shumë sundimtarë dhe ka frymëzuar shumë poetë, shkrimtarë dhe artistë. Qyteti është qendra ekonomike e administrative e rrethit me të njëjtin emër. Të ardhurat mujore mesatare në qarkun e Gjirokastrës llogariten në 45.906 Lekë (2007), krahasimisht e lartë referuar mesatares në nivel kombëtar (38.141 Lekë).

Baza e ekonomisë në qarkun e Gjirokastrës mbetet bujqësia e blegtoria, por në

rajon po rritet dhe industria e përpunimit të ushqimit, duke shfrytëzuar mundësinë që jep prodhimi i frutave, perimeve dhe nënprodukteve blegtorale. Qyteti ka universitet dhe është qendër administrative rajonale. Turizmi po tregon se është një nga shpresat më të mëdha për zhvillimin ekonomik të qytetit, duke u bazuar në trashëgiminë unike kulturore, historike dhe arkitekturore.

Aktivitete të tjera kryesore ekonomike në rajonin e Gjirokastrës janë tregtia, industria e përpunimit të qumështit dhe prodhimit të djathërave dhe nënprodukteve të tjera të qumështit etj. Industria e tregtimit dhe përpunimit të drurit gjithashtu ka gjetur zhvillim shoqëruar me industrinë e prodhimit të inerteve dhe ndërtimit. Veçohen gjithashtu repartet e shumta të prodhimit të veshjeve dhe këpucëve për tregjet e huaja. Industria e nxjerrjes dhe përpunimit të gurit për ndërtim dhe atij dekorativ.

Lezha

Qarku i Lezhës shtrihet në një pozitë të favorshme gjeografike, me 38 km vijë bregdetare. Ndodhet në kryqëzimin e artereve kryesore të transportit rrugor, detar, ajror dhe hekurudhor, ku alternohen relievet e spikatura të natyrës shqiptare, burime të bollshme ujore, florë dhe faunë e pasur duke krijuar kushte dhe mundësi zhvillimi për banorët e këtij rajoni e më gjerë.

Popullsia e qarkut të Lezhës, është 240 253 dhe përbëhet nga 5 bashki dhe 16 komuna, me 9 qytete dhe 170 fshatra. Qarku i Lezhës ka një sipërfaqe prej 1588.4 km² dhe kufizohet me qarkun Shkodër në veri, qarqet Kukës dhe Dibër në verilindje, lindje dhe juglindje, qarkun e Durrësit në jug dhe shtrihet përgjatë bregdetit të Adriatikut në perëndim me një vijë bregdetare prej 38 km. Territori i Lezhës përbëhet nga një zonë malore në lindje (65%) dhe zona fushore në perëndim (35%).

Pozicioni gjeografik i qarkut Lezhë – në qendër të arterieve kryesore të transportit që lidhin veriun me jugun dhe lindjen me perëndimin në rrugë tokësore, si edhe afërsia e tij me portet kryesore detare si ai i Durrësit dhe i Shëngjinit (ky i fundit, pjesë e territorit të qarkut), e bën këtë rajon një zonë mjaft tërheqëse dhe lehtësisht të arritshme jo vetëm në plan kombëtar, por edhe ndërkombëtar, si: Italia, Mali i Zi, Kosova, Maqedonia dhe Greqia. Një element i rëndësishëm për zhvillimin e potencialeve të qarkut përbëjnë edhe burimet e shumta hidrike, lidhjet hekurudhore që shtrihen deri në Malin e Zi, transportin ajror duke pasur parasysh afërsinë me aeroportin ndërkombëtar “Nënë Tereza” dhe aeroportin e Gjadrit (i cili ende nuk është funksional).

Shumica e popullsisë jeton në qendrat urbane (rreth 53%), ndërsa 47% jetojnë në zonat rurale dhe mesatarja e moshës së popullsisë është 34.6 vjeç. Të ardhurat mesatare mujore në vitin 2007 ishin 24.614 lekë, në një kohë që mesatarja kombëtare ishte 38 000 lekë duke pasqyruar vështirësitë ekonomike të këtij rajoni. Mesatarja e papunësisë në nivel qarku është 24.2 % dhe varion nga 11.6% në rrethin e Lezhës deri në 44% në rrethin e Kurbinit, tregues ky edhe për ndryshimet e mëdha brenda qarkut.

Nga ana tjetër, 56.6% e të punësuarve janë në sektorin privat, ndërsa 43.4% në atë publik (shtetëror) çka nxjerr në pah nivelin ende jo të kënaqshëm të zhvillimit të sektorit privat kundrejt rëndësisë që merr sektori publik si një burim të ardhurash për familjet.

Qarku i Lezhës ka qenë një zonë me ekonomi kryesisht industriale (miniera, industri ushqimore, kimike) dhe bujqësore deri në fillim të viteve 1990. Me fillimin e proceseve demokratike qarku i Lezhës u përball me sfida të mëdha nga pikëpamja e transformimit, drejt një ekonomie të hapur tregu e cila në ditët e sotme është e përqendruar kryesisht në industrinë e materialeve dhe aktiviteteve të ndërtimit, bujqësi dhe peshkim.

Disa prej problemeve thelbësore të identifikuar në qarkun e Lezhës janë mungesa e qendrave rinore, infrastruktura e marketingu i dobët, mosndërgjegjësimit i qytetarëve, mosaktivizim i rinisë në dhënien e ideve, mungesë e njerëzve të specializuar në administratë, mungesë e metodave motivuese në mësimdhënie, mungesë e aktiviteteve kulturore, mos-shfrytëzimi i duhur i burimeve natyrore, kaosi urban, keqmenaxhimi i fondeve publike, ndotja e mjedisit, mos-shfrytëzimi i zonës industriale, mungesa e politikave afatgjata, mungesë bashkëpunimi, shpyllëzimi etj. Në territorin e qarkut operojnë rreth 2.978 kompani private, nga të cilat thuajse 85% janë ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM).

Krahas partneriteteve me aktorë kombëtarë e rajonalë, adresimi i sfidave të zhvillimit social-ekonomik në rajonin e Lezhës dhe jo vetëm, imponon konsolidimin e bashkëpunimit me aktorët e duhur të zhvillimit në qark, por gjithashtu edhe me partnerë në qarqet fqinje me të cilat Lezha ndan problematika, avantazhe dhe mundësi të përbashkëta.

Qarku i Shkodrës është në këtë kontekst një nga rajonet me të cilat Lezha ka qenë dhe mbetet tradicionalisht e lidhur. Kjo marrëdhënie bashkëpunimi, mbase deri diku edhe preferenciale krahasuar me qarqet e tjera, duhet të konceptohet si një partneritet mes dy rajonesh, të cilët jo vetëm ndajnë problematika dhe mundësi të përbashkëta, por janë gjithashtu komplementarë në sektorë të ndryshëm. Kështu, të dy qarqet janë të njohur për vlerat dhe monumentet historike e kulturore, me burime të rëndësishme natyrore, me një potencial të konsiderueshëm zhvillimi ekonomik dhe pika thelbësore komunikimi me fqinjët veriorë (Mali i Zi) dhe verilindorë (Kosova) të cilat mund të konsiderohen si potenciale strategjike për të gjithë vendin.

2.2 Grupet e synuara dhe përfituesit

2.2.a Fokusi tek zonat rurale dhe periferike

Studimet mbi shoqërinë civile (të rishikuara dhe përmbledhura në studimin: "Shoqëria civile në zonat rurale dhe periferike në Shqipëri: Nevojat, sfidat dhe një platformë veprimi", IDM 2012) theksojnë se pjesa më e madhe e problematikave që lidhen me OShC-të në Shqipëri mund të merren si të mirëqena edhe

për OShC-të e zonave rurale dhe periferike. Në fakt, literatura mbi identifikimin, pozicionimin, kapacitetet dhe veprimtaritë e këtyre shoqatave ka qenë dhe mbetet më e pakët sesa ajo për zhvillimet e përgjithshme të sektorit.

Kur përpqesh të analizosh dhe vlerësosh dinamikat e shoqërisë civile në Shqipëri, një nga problematikat më evidente rezulton të jetë përqendrimi dhe mbivendosja e aktivitetit të OShC-ve në zonat urbane dhe prezenca e tyre e vakët apo mungesa totale në zonat rurale dhe periferike. Në përgjithësi, shumica e OShC-ve shqiptare janë të bazuara në Tiranë dhe një pjesë më e vogël bazohen në qytetet e Shqipërisë Qendrore (Durrës, Elbasan), në veri (Shkodër) dhe në jug (Vlorë, Gjirokastër). Ndërkohë, sipas të dhënave të një pyetësoi të vitit 2009, 89% e OShC-ve bazohen dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Tiranë dhe në qytetet kryesore dhe vetëm 11% e tyre bazohen dhe punojnë në qyteza dhe fshatra.¹

Edhe pse OShC-të shqiptare që veprojnë në zonat rurale dhe periferike janë të vogla, kanë pak staf me kohë të plotë, kanë aftësi profesionale dhe përvojë të kufizuar dhe nuk kanë qëndrueshmëri financiare, ato luajnë një rol të rëndësishëm për zhvillimin rural, i cili në pjesën më të madhe të tij mbetet ende për t'u zbuluar.

Për vlerën e madhe dhe kontributin e pazëvendësueshëm që shoqëria civile luan në zhvillimin e qëndrueshëm dhe konsolidimin e qeverisjes së mirë, veçanërisht në zonat rurale ku prezenca e saj është shumë e limituar iniciativa të ndryshme duhet të ndërmerren për të lehtësuar përballjen me sfida të tilla si:

- Mungesa e literaturës dhe studimeve specifike që lidhet me OShC-të që veprojnë në zonat rurale në Shqipëri.
- Numri i vogël i OShC-ve që punojnë në nivel komune ose fshati dhe mungesat në kapacitete dhe qëndrueshmëri financiare.
- Faktin se pavarësisht se ka përpjekje për të përmirësuar kapacitetet e tyre organizative duke krijuar federata ato mbeten të dobëta dhe shpesh nuk funksionojnë siç duhet duke qenë se varen nga dëshira dhe kontributi i komunitetit në komunën apo fshatin ku ato veprojnë.
- Mungesa e kapaciteteve për përgatitjen e projekt-ideve, si dhe ndërtimin e koalicioneve dhe advokacinë ndër këto organizata.
- Mbetja periferike e sfidave dhe shqetësimeve të komuniteteve rurale, përfshirë edhe çështjen e aktivizimit të sektorit të tretë në këto fusha, në agjendën dhe programin e organizatave të njohura të shoqërisë civile.
- OShC-të e komuniteteve rurale edhe kur ekzistojnë u mungon përvoja e duhur, kapacitetet ose rrjeti i aktorëve/qytetarëve që do të kontribuonte për qeverisjen vendore, zhvillimin e komunitetit si edhe për përshpejtimin e procesit të aderimit në BE.

Në një kontekst të tillë u ideua edhe ESCRA për të kontribuar në mënyrë të

1 Euclid dhe Human Development Promotion Center (2009), 31

drejtpërdrejtë për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe qeverisjen e mirë përmes mbështetjes së shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike në përballjen me sfidat kryesore të saj dhe rritjen, zhvillimin dhe konsolidimin e praktikave të reja/të mira.

2.2.b Sfida për fuqizimin e qytetarëve dhe inkurajimin e qeverisjes së mirë.

Indeksi për Shoqërinë Civile (IDM & CIVICUS, 2010) dokumentoi nivelet e ulëta të angazhimit qytetar dhe aktivizmit të tyre me shoqërinë civile në Shqipëri. Aktivizmi i ulët i qytetarëve, shoqërohej edhe me largësinë e OShC-ve ndaj nevojave të tyre si dhe me nivelin e ulët të impaktit të iniciativave të ndërrmarra prej shoqërisë civile. Transparenca dhe përgjegjshmëria, principet bazë për qeverisjen e mirë, rezultuan të ishin edhe shqetësimet kryesore për stukturat e shoqërisë civile. Si të tilla ato vlerësohen me një ndikim shumë të madh në integritetin dhe moralin e OShC-ve shqiptare për të ndikuar dhe shtyrë përpara qeverisjen e mirë, në nivel lokal apo qendror qoftë ajo.

Në përgjithësi, qytetarët shqiptarë shfaqnin nivele të larta "indiference" përsa i takon angazhimit të tyre në veprimtari të ndryshme shoqërore, që përbën në fakt një tipar të përbashkët dhe të njohur edhe në shoqëritë e vendeve në tranzicion apo në fazat e para të pas tranzicionit, me një shtresë të mesme relativisht të papërcaktuar dhe me nivele të larta pabarazie. ISHC tregoi se qytetarët shqiptarë kanë më shumë gjasa ta shpenzojnë kohën e tyre në mënyrë sporadike me persona të tjerë në aktivitete sociale sesa të jenë anëtarë aktivë të organizatave shoqërore.

Ndonëse aktivizmi social nuk rezultoi i kufizuar në grupe specifike shoqërore, ai mbetet shumë i ulët edhe pas shumë përpjekjeve të bëra nga partnerët ndërkombëtarë, aktorët e shoqërisë civile shqiptare dhe komuniteti i donatorëve për trajtimin e çështjeve të demokratizimit dhe mirëqeverisjes. Vetëm kohët e fundit fokusi është zhvendosur drejt qytetarisë aktive për të adresuar nivelet e ulëta të anëtarësimit dhe vullnetarizimit në organizatat shoqërore të cilat flasin për indiferencën e qytetarëve shqiptarë përsa i takon angazhimit qytetar dhe shoqërisë civile në përgjithësi. Në rast se do të kishte një qasje më të përshtatshme dhe do të kishte bashkërendim të veprimeve, atëherë mund të pritej një nivel më i lartë i angazhimit qytetar.

Nga ana tjetër, OShC-të shqiptare vazhdojnë të mbeten të varura nga agjendat dhe prioritetet e donatorëve në një shkallë të lartë. Kjo rezulton në një nivel të ulët qëndrueshmërie dhe stabiliteti për këto organizata. Për pasojë edhe impakti i punës së shoqërisë civile rezulton tejet i fragmentuar qoftë gjeografikisht apo tematikisht. Situatë kjo e predispozuar të përkeqësohet në një atmosferë ku tërheqja e donatorëve po kthehet në trend.

Mungesa e aktorëve aktivë të shoqërisë, veçanërisht në zonat rurale dhe periferike, u mohon komuniteteve të këtyre zonave përfitimet e një qeverisjeje me pjesëmarrje dhe të orientuar drejt qytetarëve si edhe nga avantazhet e pro-

cesit të integritit. Në mënyrë që shoqëria civile të mund të plotësojë detyrat, përgjegjësitë dhe pritshmëritë e saj në ndërtimin e demokracisë dhe nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm ajo ka nevojë për një mjedis mundësues dhe jo pengues. Këtë mjedis mund dhe duhet ta mundësojnë qeveria dhe donatorët përmes mbështetjes financiare dhe politikave dhe strategjive të tyre. ECSRA ishte një prej përpjekjeve për të mundësuar një mjedis më mbështetës dhe inkurajues për shoqërinë civile dhe angazhimin qytetar në zonat rurale dhe periferike, ku problematika është edhe me e mprehtë.

2.3 Strategjia e ndërhyrjes dhe përqasja metodologjike e ECSRA

Siç u njohët shkurtimisht në seksionin 1.2 mbi veprimtarinë e projektit, me qëllim arritjen e objektivave të tij dhe impaktit të synuar, iniciativa e ndërtoi strategjinë e ndërhyrjes dhe përqasjen metodologjike rreth katër komponentëve kryesore: Vlerësimit; Ndërtimit të kapaciteteve; Ndërgjegjësimit dhe Ndarjes së eksperiencave dhe advokimit. Në këtë seksion do të njiheni më në detaje me strategjinë e ndjekur dhe përqasjen metodologjike të aplikuar për secilin komponent.

2.3.a Komponenti i vlerësimit dhe disenjimit të strategjisë së punës:

Strategjia e ndërhyrjes filloi me një vlerësim të situatës. Përmes një studimi u synua identifikimi i nevojave të OShC-ve në zonat rurale dhe periferike të Shqipërisë duke ofruar informacion të detajuar për natyrën, mundësitë, sfidat, nevojat, si dhe boshllëqet në fushat tematike të veprimtarive të tyre në këto zona. Zonat gjeografike specifike ku u shtri studimi ishin ato në të cilat do të realizohej edhe ndërhyrja: qarqet Gjirokastrë, Berat, Lezhë dhe Elbasan duke u përpjekur që të mbulohej edhe diversiteti i zhvillimit në Shqipëri. Studimi realizoi këto objektiva:

- Identifikim të OShC-ve kryesore që veprojnë në zonat rurale të qarqeve Berat, Gjirokastrë, Lezhë dhe Elbasan dhe i profileve të tyre;
- Matje të nivelit të njohurive të OShC-ve mbi rolin e shoqërisë civile;
- Krahasim ndërmjet OShC-ve të zonave rurale dhe atyre të zonave urbane duke nxjerrë në pah ndryshimet dhe ngjashmëritë ekzistuese ndërmjet tyre;
- Identifikim të fushave tematike të zhvilluara dhe të suksesshme;
- Identifikim të sfidave kryesore dhe nevojave ekzistuese;
- Hartëzim të zonave gjeografike që do të mbuloreshin me nisma konkrete dhe i boshllëqeve që lidheshin me fushat tematike të pa mbuluara;
- Shtjellim të mundësive që OShC-të rurale të ndërtojnë dhe zgjerojnë më tej partneritetet dhe kapacitetet e tyre, sidomos në kuadër të anëtarësimit në BE (programet e asistencës së BE-së për zhvillimin rural);
- Vlerësim të sfidave për një rol kuptimplotë të OShCR-ve në përmirësimin e qeverisjes vendore, fuqizimin e komunitetit dhe të grupeve të marginalizuara dhe vulnerable, përfshirë çështjet e grave, të rinjve dhe të komunitetit rom.

Përqasja metodologjike që u aplikua ishte ajo e metodave mikse të kërkimit. Studimi përdori një kombinim të teknikave të mbledhjes dhe analizimit të të dhënave sasiore me ato cilësore. Teknikat e përdorura për kryerjen e studimit vlerësues përfshin:

Rishikim të burimeve

Ekipi kërkimor mbledhi dhe përdori një gamë të gjerë dokumentesh të ndryshëm që përmbanin informacion mbi historinë dhe situatën aktuale të shoqërisë civile në zonat urbane dhe rurale të Shqipërisë. Pjesë e dokumenteve të rishikuara ishin raportet studimore për shoqërinë civile.

në Shqipëri, raportet për veprimtari nga grupe të ndryshëm OShC dhe nga rrjete të ndryshëm, lista dhe statistika për OShC-të shqiptare, manuale dhe dokumente përkatës trajnuës si edhe materiale të ndryshme referencash nga interneti. Vëmendje e veçantë iu kushtua raporteve të mëparshëm për sektorin e shoqërisë civile në zonat rurale në përgjithësi si edhe në zonat e synuara nga projekti (qarqet Berat, Elbasan, Gjirokastrë dhe Lezhë) në veçanti. Rishikimi i dokumenteve të qeverisjes dhe institucioneve vendorë si edhe i raporteve dhe statistikave për veprimtaritë e OShC-ve dhe nevojat e tyre në fushat specifike ku ato veprojnë mundësoi informacion mbi specifikat e zonave të synuara dhe krijoi terrenin e përshtatshëm për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave sasiore dhe cilësore.

Intervista të thelluara me informatorët kyç

Intervista të thelluara u zhvilluan me informatorët kyç me qëllim eksplorimin e situatës aktuale të shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike të qarqeve të përzgjedhur. Intervistat nxorën në pah informacion për nivelin e aktivizimit të ShC-së rurale, për njohuritë që ajo ka mbi rolin që duhet të luajë në komunitet dhe në sistemin e qeverisjes vendore, për llojet e nismave/veprimtarive ekzistuese në zonat relevante, për sfidat dhe nevojat specifike me të cilat përballlet përgjatë implementimit të veprimtarive të saj, për pikat e forta dhe ato të dobëta, si edhe për ato të cilat perceptohen prej aktorëve të saj si 'hapat e ardhshëm' për ri-orientimin e OShCR-ve drejt rritjes së fokusit rural në kuadër të zhvillimit dhe sfidave të integritit.

Informatorët kyç përbëheshin nga përfaqësues të OShC-ve, udhëheqës vendorë, përfaqësues të medias, të qeverisë dhe përfaqësues të institucioneve vendorë. Intervistat e thelluara shërbyen gjithashtu edhe si mjet për identifikimin e aktorëve kryesorë lokalë dhe të tematikave të analizës që do të mbuloreshin prej pyetësorit përgjatë fazës vijuese të projektit. Ky instrument u përdor në dy stadi të procesit të vlerësimit të nevojave. Më konkretisht, në fillim të vlerësimit, duke synuar identifikimin e problematikave dhe në fund të tij (pas sondazhit dhe grupeve të fokusuara) me synim qartësimin e prirjeve dhe validimin e tyre.



Sondazh

Një sondazh u zhvillua me aktorët kryesorë vendorë për të përcaktuar nevojat dhe mundësitë për zhvillimin e shoqërisë civile në zonat e synuara. Pyetësi i sondazhit synoi kryesisht përfaqësues të OShC-ve rurale (grupet përfitues të cilave ishin kryesisht gratë, të rinjtë, komuniteti Rom, moshat e thyera, etj.), si dhe përfaqësues nga media dhe përfaqësues të qeverisjes vendore. Grupi i pyetjeve u zhvillua bazuar në objektivat specifike të projektit si edhe në gjetjet e gjeneruara nga intervistat e thelluara me informatorët kyç.

Diskutime në fokus-grupe

Diskutimet në Fokus-Grupe (FG) u organizuan me grupe të komunitetit të mbështetur nga OShC-të në zona të ndryshme për të testuar vlefshmërinë e gjetjeve që dolën nga pyetësi dhe intervistat e thelluara. Zgjedhja e pjesëmarrësve u bazua mbi kriterin e përfituesve relevantë. Këta u organizuan në grupe diskutimi prej 8-12 personash bazuar në tematikat e ndryshme që u adresuan gjatë procesit të vlerësimit (duke përfshirë gjetjet e pyetësorit dhe ato të intervistave të thelluara). Për secilën nga zonat e synuara u organizuan dy diskutime në FG duke arritur një total prej 8 FG me mbi 60 pjesëmarrës.

Gjetjet e studimit shërbyen si bazë për ndërtimin e strategjisë për vazhdimësinë e ndërhyrjes si dhe planin e detajuar të aktiviteteve për çdo fazë. Ato u botuan në një botim dygjuhësh – shqip dhe anglisht, dhe u shpërndanë gjerësisht tek aktorët dhe grupet e interesit.

2.3.b Komponenti i ndërtimit të kapaciteteve:

Manuali për OSHC-të

Bazuar në gjetjet e studimit për vlerësimin e nevojave të ShC në zonat rurale

dhe periferike skuadra e IDM-së hartoi manualin për OShC-të në zonat rurale dhe periferike. Manuali u disenjua për t'u ardhur në ndihmë përfaqësuesve të shoqërisë civile për të menaxhuar më mirë organizatat e tyre në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë, menaxhimit të përgjegjshëm, llogaridhënies dhe për të rritur kapacitetet e tyre për zhvillimin e programeve dhe ciklin e menaxhimit të projektit. Drafti i parë i manualit u konsultua edhe me skuadrën kërkimore të studimit vlerësues për një adresim sa më të mirë edhe të nevojave të identifikuara përmes vlerësimit.

Manual mbi partnershipet trepalëshe

Në vijimësi të aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve u hartua një manual i veçantë mbi partneritetet dhe bashkëpunimet trepalëshe midis shoqërisë civile, pushtetit vendor dhe sektorit privat. Audiencia parësore për këtë manual ishin aktorët e qeverisjes vendore, të cilët mund ta përdornin manualin si një mjet për ndërtimin e bashkëpunimeve trepalëshe. Të dy manualët u printuan dhe u shpërndanë jo vetëm në zonat e targetuara nga projekti dhe pjesëmarrësit në trajnime, por edhe tek aktorë të tjerë të interesuar në të gjithë vendin. Ato janë gjithashtu të vlefshëm për t'u konsultuar online në faqen e IDM www.idmalbania.org.

Seri trajnimesh mbi ciklin e projektit dhe menaxhimin e OShC-ve

Përgatitjet për këtë komponent ishin të hershme, që me nisjen e iniciativës, gjithsesi përqaqja metodologjike për disenjimin dhe zbatimin e tyre ishte e tillë që të reflektoheshin edhe nevojat e identifikuara. Kështu, seria e trajnimeve filloi vetëm pasi rezultatet e studimit për vlerësimin e nevojave ishin bërë të njohura.

Workshop-e interaktive

Duke ndërtuar mbi eksperiencën e krijuar gjatë trajnimeve me përfaqësues të OShC-ve IDM planifikoi dhe implementoi workshope interaktive me përfaqësues të pushtetit vendor, agjencive publike dhe sektorit privat që operonin në qarqet e targertuara: Elbasan, Berat, Lezhë dhe Gjirokastër. Gjatë tyre u përdorën dhe shpërndanë edhe manualët e përgatitura.

WorkshoPET patën një mision të dyfishtë. Së pari, shërbyen për të rritur ndjeshmërinë tek aktorët publik dhe privatë mbi rolin e rëndësishëm që secili prej tyre ka dhe mund të luaj për një shoqëri civile më vitale. Së dyti, ato shërbyen si një hap fillestar për nxitjen dhe vendosjen e kontakteve dhe marrëdhënieve bashkëpunuese midis këtyre aktorëve.

Workshop-i Kombëtar

Ky workshop u bazua në gjetjet e studimit vlerësues si dhe në draft strategjinë e disenjuar me qëllim rivitalizimin e shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike. Ai shërbeu jo vetëm për t'i dhënë më shumë vlefshmëri dhe besueshmëri gjetjeve të vlerësimit, por edhe për të finalizuar planin dhe strategjinë e ndërhyrjes për fazat në vijim. Kjo u realizua me pjesëmarrjen e gjerë dhe aktive të institucioneve shtetërore, donatorëve, shoqërisë civile, sektorit privat, medias etj. Rreth 170

pjesëmarrës debatuan në këtë event një-ditor nën mbulimin e gjerë të medias.

2.3.c Komponenti i rritjes së ndërgjegjësimit dhe njohurive:

Spoti televiziv dhe radiofonik

Një spot televiziv u përgatit duke u bazuar në një analizë gjithëpërfshirëse mbi alternativat më të mira për një përfshirje më të madhe në konsolidimin e shoqërisë civile në këto zona. Analiza u bazua ndër të tjera edhe në studimin për vlerësimin e nevojave të realizuar po në kuadër të projektit. Spoti përfshiu imazhe nga aktivitetet e projekteve të mbështetura nga iniciativa. Ai u transmetua në TV-të lokale të zonave të targetuara për një periudhë disa mujore. Paralelisht me të, IDM u kujdes që mesazhe të ngjashme të përcilleshin edhe përmes radiove lokale. Mesazhi kryesor i përcjellë përmes tyre ishte për nxitjen e qytetarisë aktive, fuqizimin e komunitetit dhe përmirësimin e jetës në të përmes pjesëmarrjes më të madhe në sektorin e shoqërisë civile.

Materialet e shtypura

Përveç spoteve televizive dhe radiofonike për rritjen e ndërgjegjësimit u përdorën edhe një sërë mjeteve të tjera si buletinet informative, manuale dhe fletëpalosjet. Përmes tyre u targetuan katër zonat e përfshira në studim, por edhe më gjerë. Gjithsej u hartuan, botuan dhe shpërndanë 6 buletine dhe 2 manuale me një minimum tirazhi prej 300 kopjesh secili. Aksesi ndaj tyre online ishte dhe vazhdon të mbetet i lirë për përdorim në çdo kohë në faqen e IDM www.idmalbania.org. Fletëpalosjet dhe fletëvolantet (500 kopje) u shpërndanë edhe më gjerë sesa materialet e tjera.

2.3.d Komponenti i ndarjes së eksperiencave dhe advokimit:

Ndarja e eksperiencave dhe advokimi u realizua përmes workshop-eve, "Panairit të Ideve" dhe konferencave.

Organizimi i dy workshop-eve zonale

Qëllimi i tyre ishte lehtësimi dhe çuarja përpara e përpjekjeve të aktorëve lokalë për të punuar dhe mbështetur shoqërinë civile të zonave të targetuara nga iniciativa. Dy workshop-et mblodhën përfaqësuesit e Elbasanit dhe Lezhës së bashku në njërin prej tyre dhe Beratit dhe Gjirokastrën në të dytin. Kjo zgjidhje u bë pikësëpari me qëllim shkëmbimin ndërzonal. Përfaqësuesit në workshop-eve vinin nga të tre shtyllat e bashkëpunimit të pritshëm dhe të inkurajuar nga iniciativa – shteti, sektori privat dhe shoqëria civile. Për t'i dhënë më shumë mundësi dhe kohë hedhjes dhe debatimit të ideve në këto workshope, IDM përgatiti dhe shpërndau tek pjesëmarrësit në avancë materiale informative, gjë që u pa me interes dhe u vlerësua prej pjesëmarrësve. Këto evente u shfrytëzuan edhe për informimin e pjesëmarrësve mbi Panairin e Ideve dhe mundësitë që do të ofroreshin gjatë tij, procesin dhe kriteret.

Panairi i Ideve

Mund të cilësohet edhe si zemra e projektit duke qenë se u ideua dhe u zbatua

në mënyrë të tillë që të lidhte dhe kanalizonte zhvillimet e projekti nga faza e ndërgjegjësimit, ngritjes së kapaciteteve dhe gjenerimit e thithjes së ideve tek përzgjedhja, mbështetja e tyre e për pasojë kontributin direkt për rivitalizimin e shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike. Për të marrë pjesë në të u kontaktuan dhe ftuan mbi 120 OShC dhe aktorë të tjerë që punonin apo ishin të interesuar për të ndërmarrë/mbështetur iniciativa të shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike. Në përgjithësi pati një prezencë të madhe të komunitetit të aktorëve të pushtetit vendor, donatorëve dhe biznesit si dhe aktiviteti gjeti një pasqyrim shumë të mirë në media. Ndonëse interesi i shprehur dhe idetë e ofruara fillimisht shkonin tek rreth 100 iniciativa, vetëm 60-të arritën të konkretizohen në aplikime për raundin e parë pasi bazuar edhe në nivelin e zhvillimit të OShC-ve në këto zona, pengesë shpesh bëhej mungesa e stafit financiar/menaxherial dhe veçanërisht çështje legale të lidhura me regjistrimin apo sistemin e taksimit për OShC-të në Shqipëri.



ECSRA: ZBATIMI DHE IMPAKTI

3.1 Komponenti: Vlerësim dhe ndërtim strategjie

Përshkrimi dhe zbatimi

Për një strategji ndërhyrjeje sa më efektive në adresim të nevojave të shoqërisë civile në zonat e targetuara nga ECSRA, projekti u iniciua nga një studim për vlerësimin e nevojave. Studimi synoi identifikimin e nevojave të OShC-ve në zonat rurale dhe periferike të Shqipërisë duke ofruar informacion të detajuar për natyrën, mundësitë, sfidat, nevojat dhe boshllëqet në fushat tematike të veprimtarive të tyre në këto zona.

Zonat gjeografike specifike ku u shtri studimi ishin ato në të cilat do të realizohej edhe ndërhyrja: qarqet Gjirokastrë, Berat, Lezhë dhe Elbasan duke u përpjekur që të mbulohej edhe diversiteti i zhvillimit në Shqipëri. Studimi realizoi objektivat e tij përmes një përqasje metodologjike mikse për të mundësuar matjen e shtrirjes së problematikave dhe nevojave, por edhe thellësinë dhe larmishmërinë e tyre.

Për realizimin e tij u angazhuan skuadra kërkimore e vendosur në Tiranë si dhe 4 asistentë të përzgjedhur nga zonat e targetuara. Kjo zgjedhje ishte rezultat i pikave të forta që partnerët lokalë sillnin në aplikimin e studimit me njohjen e mirë të situatës, aktorëve lokalë dhe kostot më të ulëta për administrimin e procesit të mbledhjes së të dhënave parësore në terren.

Për të rritur vlefshmërinë e gjetjeve dhe ndjenjën e autorësisë ndaj tyre tek komunitetet e zonave të synuara, drafti i raportit të studimit u nda dhe u diskutua me përfaqësues nga këto komunitete. U organizuan 4 fokus-grupe, një për secilin qark, ku përveç diskutimeve mbi vlefshmërinë e gjetjeve u gjeneruan edhe një sërë rekomandimesh konkrete që i shërbyen planifikimit dhe strategjisë për hapat e mëtejshme të projektit.

Fokus-grupet u organizuan në Gjirokastrë (dt. 5 Nëntor 2011), në Berat (dt. 7 Nëntor 2011), në Lezhë (dt. 10 Nëntor 2011) dhe në Elbasan (dt. 11 Nëntor 2011). Argumentet dhe rekomandimet e gjeneruara gjatë këtyre diskutimeve u

reflektuan dhe u bënë pjesë e variantit final të raportit. Për ta plotësuar procesin, raporti final u prezantua dhe diskutua në një konferencë kombëtare me pjesëmarrjen e gjerë të aktorëve kyç të qeverisjes qendrore dhe vendore, shoqërinë civile, donatorët, median dhe aktorë të tjerë që punojnë për forcimin e shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike.

Rezultate

Produktet kryesore të këtij komponenti ishin raporti studimor mbi vlerësimin e nevojave të shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike të qarqeve të targetuara nga projekti si dhe plani strategjik i punës për implementimin e komponentëve të tjerë të ECSRA.

Raporti studimor u botua në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Rreth 500 kopje të printuara u shpërndanë gjerësisht në zonat e targetuar dhe në nivel qendror. Ndërkohë, formati soft i të dy varianteve të raportit u vendos për akses të gjerë e të vazhdueshëm në faqen e IDM www.idmalbania.org.

Studimi Vlerësues “Arritjet dhe Nevojat e Shoqërisë Civile në Zonat Rurale dhe Periferike”, konfirmoi faktin se shoqëria civile në këto rajone mbetet ende në një fazë embrionale. Zonat rurale dhe periferike janë pak atraktive për organizatat që punojnë në nivel kombëtar apo ndërkombëtar. Organizatat e shoqërisë civile me qendër në zonat rurale janë jo vetëm të pakta në numër, por edhe me një aktivitet modest dhe shpesh sporadik. Aktiviteti i ulët i shoqërisë civile dhe ndikimi i dobët i punës së saj në këto zona ishte një perceptim që ndanin si përfaqësuesit e shoqërisë civile, ashtu edhe aktorët e tjerë në komunitet.

Pranohej gjerësisht se puna në zonat rurale/periferike ka më tepër sfida dhe vështirësi se ajo në zonat urbane, por gjithashtu identifikoheshin edhe avantazhe dhe veçori që e bëjnë atë interesante dhe shpërblyese. Të qenit më pranë grupeve të interesit dhe mundësia për komunikim të drejtpërdrejtë, vlerësohen si një mundësi për ndikim të qëndrueshëm në kushte normale. Po kështu ndryshimet që sjell puna e aktorëve të shoqërisë civile në këto zona të vogla bëhet më e ndjeshme, konkrete dhe e prekshme, cilësi që ndikojnë drejtpërdrejt edhe në përforcimin e besimit midis tre palëve; shoqëri civile – komunitet – pushtet vendor.

Nevoja për të mbijetuar, pavarësisht vështirësive, i detyron një pjesë të mos jenë qartësisht të fokusuar në misionin dhe aktivitetin e punës së tyre duke përfshirë në të një larmishmëri qëllimesh, objektivash, aktiviteteve dhe përfituesish. Imazhin e shoqërisë civile në zonat rurale e ka përmirësuar veçanërisht puna që është bërë për adresimin e çështjeve që lidhen me advokacinë dhe lobimin për grupe të caktuara interesi apo për zonën në tërësi, për të drejtat e grave dhe fëmijëve; ruajtjen dhe promovimin e kulturës, traditës dhe zakoneve të zonës; mbrojtjen e mjedisit dhe promovimi i turizmit (kulturor dhe mjedisor); apo për promovimin e grupeve të ndryshme profesionale (p.sh fermerëve, artizanëve, gazetarëve lokalë etj.).

Ndërkohë, kërkohet që në të ardhmen shoqëria civile në këto zona të mund të kthejë sytë edhe drejt disa çështjeve që komuniteti i konsideron të rëndësishme,

por pak të prekura si drejt nevojës për vende të reja pune, projekte për zhvillimin rural e bujqësor, zhvillimin e infrastrukturës, ndërgjegjësimin e komunitetit, inkurajimin e vullnetarizmit dhe punës në komunitet, pjesëmarrjen më të madhe të grave në jetën komunitare, rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe mbrojtjen e të drejtave të minoriteve apo grupeve me nevoja të veçanta.

Ndër sfidat kryesore të identifikuar nga vlerësimi ishin:

- Kufizimet financiare, mentaliteti konservativ, mungesa e bashkëpunimit nga ana e pushteti vendor, bizneseve, medias etj.
- Paqartësia mbi mbulimin dhe shtrirjen e misionit dhe aktivitetit të aktorëve të shoqërisë civile
- Nevoja për trajnime e kualifikime
- Nevoja për përmirësimin e marrëdhënieve me publikun, median, pushtetin vendor etj.
- Nevoja për ndërtimin e partneriteteve dhe rrjeteve brenda shoqërisë civile dhe më gjerë.

Vlerësimi dhe rezultatet e tij u mirëpritën, u pranuan dhe u përkthyen në pika hyrje për strategji konkrete si për IDM ashtu edhe për shumë aktorë të tjerë të shoqërisë civile, pushtetit vendor apo edhe sektorit privat të pranishëm gjatë workshop-it kombëtar. Impakti i tij ishte i gjerë. Vetëm në workshop-in kombëtar për ndarjen dhe diskutimin e gjetjeve të vlerësimit pati një pjesëmarrje prej rreth 170 përfaqësuesish nga të tre sektorët.

3.2 Komponenti: Ndërtimi i kapaciteteve

Përshkrimi dhe zbatimi

Në kuadër të komponentit të dytë u ndërmorën aktivitete, impakti i të cilave do të rezultonte në rritje të kapaciteteve të aktorëve të shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike të qarqeve të targetuara, por edhe ndërtimi i kapaciteteve të partnerëve të tyre nga sektori shtetëror dhe ai privat në nivel lokal.

Faza e parë e këtij komponenti ishte e lidhur ngushtë me studimin vlerësues për shoqërinë civile në zonat e targetuara nga iniciativa. Ndarja e gjetjeve kryesore të studimit në tryeza me përfaqësues të sektorit dhe diskutimi i tyre me synim planifikimin e ndërhyrjeve të tjera dhe ofrimin e rekomandimeve u konsiderua një aktivitet jo vetëm informues, por edhe kontribues në ngritjen e kapaciteteve veçanërisht lidhur me njohjen e kapaciteteve që ato gëzojnë, analizave të pikave të forta e të dobëta, të mundësive dhe kërcënimeve si dhe ideimin dhe hartimin e strategjive ndërhyrëse për adresimin e tyre.

Faza e dytë, iu dedikua krijimit të burimeve të nevojshme për ngritjen e kapaciteteve në raport me nevojat kryesore të identifikuar nga vlerësimi. Kështu, bazuar në gjetjet e studimit për vlerësimin e nevojave të shoqërisë civile në zonat

rurale dhe periferike skuadra e IDM-së hartoi manualin për OShC-të në zonat rurale dhe periferike. Manuali u dizenua për t'u ardhur në ndihmë përfaqësuesve të shoqërisë civile për të menaxhuar më mirë organizatat e tyre në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë, menaxhimit të përgjegjshëm, llogaridhënies dhe për të rritur kapacitetet e tyre për zhvillimin e programeve dhe ciklin e menaxhimit të projektit. Drafti i parë i manualit u konsultua edhe me skuadrën kërkimore të studimit vlerësues për një adresim sa më të mirë edhe të nevojave të identifikuar përmes vlerësimit.

Në vijimësi të po këtij komponenti, u hartua një manual i veçantë mbi partneritetet dhe bashkëpunimet trepalëshe midis shoqërisë civile, pushtetit vendor dhe sektorit privat. Audienca parësore për këtë manual ishin aktorët e qeverisjes vendore të cilët mund ta përdornin manualin si një mjet për ndërtimin e bashkëpunimeve trepalëshe.

Të dy manualët u përcollën tek grupet e synuara përmes:

1. Një seri trajnimesh mbi ciklin e projektit dhe menaxhimin e OShC-ve me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile në këto zona; dhe
2. Workshop-eve interaktive mbi vendosjen e partneriteteve dhe bashkëpunimeve me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të pushtetit vendor, agjencive publike dhe sektorit privat që operonin në qarqet e targertuara: Elbasan, Berat, Lezhë dhe Gjirokastër. Ato shërbyen, së pari, për të rritur ndjeshmërinë tek aktorët publik dhe privatë mbi rolin e rëndësishëm që secili prej tyre ka dhe mund të luaj për një shoqëri civile më vitale; e së dyti, si një hap fillestar për nxitjen dhe vendosjen e kontakteve dhe marrëdhënieve bashkëpunuese midis këtyre aktorëve.

Rezultate

Për ndërtimin e kapaciteteve u organizuan 12 trajnime me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile me aktivitet në zonat rurale dhe periferike të qarqeve Berat, Elbasan, Gjirokastër dhe Lezhë. Në total u ngritën kapacitetet e rreth 150 përfaqësuesve të këtyre organizatave lidhur me hartimin dhe implementimin e ciklit të projektit dhe menaxhimin e OShC-ve.

Ndërkohë, në katër workshopet interaktive të mbajtura në secilin qark u ngritën kapacitetet e rreth 60-të përfaqësuesve të pushtetit vendor në këto zona lidhur me ndërtimin e partneriteteve me aktorët e shoqërisë civile dhe rolin dhe kontributin e tyre. Po kështu, përmes 8 trajnimeve po i njëjti target u trajnuar lidhur me rolin dhe përgjegjësinë e pushtetit vendor në kuadër të asistencës së Bashkimit Europian, si të përfitohet prej saj përmes përpjekjeve të bashkuara të tri partnerëve – shoqëri civile, pushtet vendor dhe sektor privat.

3.3 Komponenti: Informim dhe ndërgjegjësim

Përshkrimi dhe zbatimi

Në kuadër të projektit “*Forcimi i Kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile në Zonat Rurale dhe Periferike*”, u parashikua dhe përgatit një strategji e detajuar informimi dhe ndërgjegjësimi duke përfshirë mënyra dhe mjete të ndryshme të komunikimit.

Strategjia e komunikimit u bazua në dy komponentë kryesorë: informimin e palëve të përfshira dhe të interesuara në këtë projekt, dhe komponenti i ndërgjegjësimit e sensibilizimi i target-grupeve të ndryshme, mbi rëndësinë e forcimit të shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike, me qëllim arritjen e një vazhdimësie dhe qëndrueshmërie edhe pasi afati për implementimin e këtij projekti të ketë përfunduar.



Në bashkëpunim me përfaqësuesit e PNUD-it, ekipi i IDM-së zhvilloi fushatën mediatike dhe publike e cila u lançua me fillimin e këtij projekti. Duke iu referuar pjesës së komunikimit dhe fushatës sensibilizuese dhe ndërgjegjësuese gjatë implementimit të këtij projekti, u konceptuan 4 komponentë kryesorë:

- **Materiale promovuese** dhe informuese për publikun e gjerë mbi objektivat dhe risitë e këtij projekti. Si rrjedhojë u përgatit një fletëpalosje me informacion të përgjithshëm rreth projektit, objektivat e tij, rezultatet e pritshme, fazat implementuese dhe aktorët e synuar.

- **Botimi periodik** (çdo 3 muaj) i **Revistës Komunitare**, gjatë gjithë shtrirjes së projektit, ku u pasqyruan të gjitha zhvillimet, aktivitetet e produktet e realizuara në kuadër të këtij projekti rajonal
- **Një spot publicitar** televiziv 30 sekonda, i cili u transmetua në 4 televizione rajonale në secilin qark ku u implementua projekti.
- **Komunikim me median** dhe mbulim mediatik mbi rezultatet dhe aktivitetet e zhvilluara në kuadër të projektit dhe nismave të dala prej tij.

Materialet promovuese konsistojnë në përgatitjen e shpërndarjen e 500 fletëpalosjeve me informacionin bazë rreth projektit. Këto materiale kishin si qëllim njohjen e aktorëve të ndryshëm si organizatat e shoqërisë civile, komuniteti, pushteti lokal etj. me projektin 2-vjeçar “Forcimi i Kapaciteteve të Shoqërisë Civile në Zonat Rurale dhe Periferike” që financohet nga UNDP dhe implementohet nga IDM në bashkëpunim me organizatat lokale në qarqet Lezhë, Elbasan, Berat e Gjirokastrë.

Fletëpalosja përmbante informacion konciz rreth nismës, aktorëve të përfshirë, qëllimit të nismës dhe fakte e informacion konkret mbi situatën e zhvillimit të shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike në Shqipëri.

Faza e shpërndarjes së fletëpalosjeve, pjesë e fushatës së informimit dhe ndërgjegjësimit mbi forcimin e shoqërisë civile në zonat rurale e periferike që u shtri gjatë gjithë projektit, u realizua paralelisht me fazën e përgatitjes së aktiviteteve në kuadër të këtij projekti. Gjatë takimeve të zhvilluara në periudhën Korrik – Gusht 2012, me aktorë të ndryshëm që u përfshinë në këtë nismë si dhe gjatë diskutimeve informale me përfaqësues të shoqërisë civile e pushtetit vendor, materialet promovionale shërbyen për t’i mundësuar grupeve të ndryshme të përfshira ose interesuara në këtë projekt, një informacion bazë të nevojshëm e të kuptueshëm mbi rezultatet dhe pritshmëritë e këtij projekti.

Një instrument i përzgjedhur si pjesë e fushatës ndërgjegjësuese, ishte një spot publicitar i realizuar nga një studio profesionale publicitare me fokus ndërgjegjësimin për rëndësinë që ka një shoqëri civile e zhvilluar dhe e qëndrueshëm për zonat rurale dhe periferike. Spoti u ideua dhe u realizua në bashkëpunim të ngushtë me UNDP, IDM dhe Studio “NILOR Production”. Spoti prej 32 sekondash u transmetua në 4 televizione rajonale që mbulonin me sinjal secilin qark të përfshirë në këtë projekt gjatë një periudhe 2 mujore me një frekuencë prej 6 transmetimesh televizive në ditë, në oraret e pasdites që janë edhe më të ndjekurat. Si rrjedhojë IDM bashkëpunoi me Televizioni Skampa për qarkun Elbasanit; Televizioni Rozafa për qarkun e Lezhës; Televizioni ALPO për qarkun e Gjirokastrës dhe Televizioni GLOB për qarkun e Beratit.

Spoti, i cili u transmetua gjatë një periudhë 2 mujore, dhe arriti të ketë ndikim në grupet e synuara duke parapërgatitur terrenin për aktivitetet dhe ndërhyrjet e planifikuara në kuadër të kësaj nisme.

Spoti i drejtohej një audience të gjerë dhe kishte si qëllim sensibilizimin e komu-

nitetit dhe aktorëve të ndryshëm vendim-marrës mbi rëndësinë që kanë organizatat joqeveritare në zhvillimin e zonave rurale dhe periferike.

Revista Komunitare, një botim periodik (çdo 3 muaj) i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim, ishte një instrument informimi dhe sensibilizimi për të gjithë pjesëmarrësit në aktivitetet dhe nismat e parashikuara në kuadër të këtij projekti. Revista Komunitare mund të konsiderohet edhe si 'zëri' i projektit ECSRA, dhe u konceptua si një revistë informuese që do të përmbledhonte informacion mbi të gjitha aktivitetet e planifikuara dhe të zhvilluara në kuadër të projektit, si dhe fazat dhe produktet e këtyre nismave.

Në 4 numrat e saj të parë (6 në total të publikuara gjatë një periudhë 18 mujore), Revista Komunitare pati në fokus secilin qark ku u shtri projekti duke dhënë informacion të përgjithshëm mbi situatën social-ekonomike në secilin qark dhe një përshkrim mbi gjendjen e shoqërisë civile në secilin rajon. Ndërkohë në dy numrat e fundit fokusi u vendos kryesisht në iniciativat e implementuara me mbështetjen e ESCRA.

Revista Komunitare kishte si qëllim t'i bënte të njohur publikut dhe aktorëve të interesuar veprimtarinë në kuadër të ECSRA-s dhe aktivitetet dhe rezultatet e punës së secilës organizatë lokale. Në anën tjetër ajo synonte të ndërgjegjësonte publikun mbi anëtarësimin dhe angazhimin më aktiv të tyre në këto organizata. Si rrjedhojë Revista Komunitare shoqëroi të gjitha aktivitetet e organizatave të shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike duke informuar për aktivitetet e zhvilluara dhe të planifikuara.

Komunikimi me gazetarët dhe mbulimi mediatik gjithashtu përbëjnë një komponent mjaft të rëndësishëm gjatë gjithë fushatës së informimit publik mbi rezultatet dhe aktivitetet e zhvilluara në kuadër të projektit dhe nismave të dala prej tij. Kjo përbënte një pjesë mjaft të rëndësishme të fushatës ndërgjegjësuese në kuadër të ECSRA-s për të shtrirë ndikimin e kësaj nisme në nivel qarku e më gjerë.

Si rrjedhojë në aktivitetet e organizuara në nivel kombëtar një vëmendje e veçantë iu kushtua mbulimit mediatik, për të sensibilizuar në nivel kombëtar rëndësinë e një shoqërie të fortë civile në zonat rurale dhe periferike. Në veçanti, një mbulim të gjerë mediatik pati eventi që u zhvillua në përfundim të fazës së dytë të projektit: "Panairi i Ideve" që tërhoqi vëmendjen e televizioneve kryesore kombëtare dhe lokale.

Ndërkohë në nivel qarku, edhe organizatat joqeveritare në zonat rurale dhe periferike përdorën mediat lokale për të mbuluar zhvillimin e aktiviteteve të tyre në kuadër të nismës ECSRA dhe ndërgjegjësuar një audiencë të gjerë mbi rëndësinë dhe rezultatet e këtij projekti dhe nismave të tij. Kjo nëpërmjet aktivizimit të mediave kryesore në qarkun e Lezhës, Elbasanit, Gjirokastrës dhe Beratit.

Rezultate

Shumë prej indikatorëve sasiorë lidhur me produktet e secilit element në kuadër të ndërgjegjësimin dhe informimit u paraqitën në seksionin e mësipërm. ESCRA

nuk ndërmori ndonjë mision specifik për matjen e impaktit të kësaj fushate. Megjithatë, ajo përdori një sërë indikatorësh që demonstruan shtrirjen, efektivitetin dhe impaktin e elementeve të komponentit informim dhe ndërgjegjësim. Më poshtë po listojmë disa prej tyre:

a. ECSRA u bë e njohur gjerësisht në zonat e targetuara, por edhe më gjerë. Numri i lartë i organizatave që shprehën interes si dhe i aplikimeve ishte një prej treguesve. Po kështu, kontaktimet dhe shprehja e interesit prej aktorëve të shoqërisë civile nga zona të tjera tregoi impaktin e iniciativës, por edhe për domdoshmërinë për ndërhyrje edhe në qarqe të tjera të vendit.

b. Mbështetja e gjerë nga aktorët e pushtetit vendor dhe komuniteti i këtyre zonave ishte një tjetër tregues. Pjesëmarrja dhe interesi i treguar në aktivitetet e organizuara në nivel lokal ishte ndër të tjera rezultat i fushatës ndërgjegjësuese përmes mediave lokale të zonave të targetuara.

c. Feedbacku i vazhdueshëm dhe kontributet e shpeshta për Revistën Komunitare nga përfaqësues të shoqërisë civile në këto zona, pushtetit vendor dhe biznesit tregonin vazhdimisht për një vlerësim shumë pozitiv të këtij komponenti.

3.4 Komponenti: Ndarja e eksperiencave dhe advokimi

Përshkrimi dhe zbatimi

Për realizimin e ndarjes së eksperiencave dhe për të advokuar mbi çështjet dhe interesat zhvillimore të shoqërisë civile në përgjithësi dhe asaj të zonave rurale/periferike në veçanti u planifikuan dhe zbatuan 2 workshop-e zonale, një panair idesh për projekt-propozime dhe një konferencë përmbyllëse për gjithë iniciativën.

Qëllimi i workshop-eve zonale ishte lehtësimi dhe çuarja përpara e përpjekjeve të aktorëve lokalë për të punuar dhe mbështetur shoqërinë civile të zonave të targetura nga iniciativa. Dy workshop-et mblodhën përfaqësuesit e Elbasanit dhe Lezhës së bashku në njërin prej tyre dhe Beratin dhe Gjirokastrën në të dytin. Kjo zgjidhje u bë me qëllim shkëmbimin ndërzonar. Përfaqësuesit në workshop-e vinin nga të tre shtyllat e bashkëpunimit të pritshëm dhe të inkurajuar nga iniciativa – shteti, sektori privat dhe shoqëria civile. Për t'i dhënë më shumë mundësi dhe kohë hedhjes dhe debatimit të ideve në këto workshop-e, IDM përgatiti dhe shpërndau tek pjesëmarrësit në avancë materiale informative, gjë që u pa me interes dhe u vlerësua prej pjesëmarrësve. Këto evente u shfrytëzuan edhe për informimin e pjesëmarrësve mbi "Panairin e Ideve" dhe mundësive që do të ofroreshin gjatë tij, procesin dhe kriteret.

Ndërkohë, "Panairi i Ideve" mund të cilësohet edhe si zemra e projektit duke qenë se u ideua dhe u zbatua në mënyrë të tillë që të lidhte dhe kanalizonte zhvillimet e projektit nga faza e ndërgjegjësimit, ngritjes së kapaciteteve dhe gjenerimit e thithjes së ideve tek përzgjedhja, mbështetja e tyre e për pasojë kontributin direkt

për rivitalizimin e shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike. Më tepër detaje lidhur me zbatimin e tij mund t'i gjeni në kapitullin e praktikave të mira të ECS-RA, pjesë e këtij botimi.

Rezultate

Si workshopet zonale, ashtu edhe panairi i ideve u karakterizuan nga një interes shumë i lartë, përkthyer edhe në pjesëmarrje të madhe të grupeve të interesit. Kështu në secilin prej 2 workshop-eve zonale morën pjesë rreth 40 pjesëmarrës, përfaqësues të rreth 20 organizatave si dhe të pushtetit vendor të zonave të targetuara. Ndërkohë, për të marrë pjesë në panairin e ideve u kontaktuan dhe ftuan mbi 120 OShC dhe aktorë të tjerë që punonin apo ishin të interesuar për të ndërmarrë e mbështetur iniciativa të shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike. Në panair pati një prezencë të madhe të komunitetit të aktorëve të pushtetit vendor, donatorëve dhe biznesit si dhe aktiviteti gjeti një pasqyrim shumë të mirë në media. Ndonëse interesi i shprehur dhe idetë e ofruara fillimisht shkonin tek rreth 100 iniciativa, vetëm 60-të arritën të konkretizohen në aplikime për raundin e parë pasi bazuar edhe në nivelin e zhvillimit të OShC-ve në këto zona, pengesë shpesh bëhej mungesa e stafit financiar/menaxherial dhe veçanërisht çështje legale të lidhura me regjistrimin apo sistemin e taksimit për OShC-të në Shqipëri.

3.5 Dëshmi

1. Qarku Berat: Pushteti Vendor & Shoqëria Civile ... një aleancë në zhvillim (Intervistë me Kryetarin e Qarkut Berat – Z. Petrit Sinaj)

Si mendoni, a ka bërë mjaftueshëm pushteti vendor për të nxitur/përfshirë në partneritet aktorë të shoqërisë civile? Po me biznesin?

Mendoj se niveli në të cilin ndodhet bashkëpunimi është ende i pa-arrirë. Faktorët që ndikojnë në këtë nivel janë të ndryshëm por, më kryesorët do të përmendja: mungesa e strategjive lokale dhe mekanizmave përkatës për përfshirjen sa më të gjerë të shoqërisë civile dhe biznesit në probleme dhe projekte që kanë të bëjnë me komunitetin. OJF-të e rajonit të Beratit për shkak të mungesës së fondeve dhe distancës fizike nga donatorët kryesorë, nuk kanë arritur të fuqizohen dhe të përfaqësojnë apo të prezantohen fuqishëm në sytë e komunitetit dhe pushtetit lokal. Kjo ka ndikuar në një lidhje të dobët mes pushtetit vendor-OJF-komunitet. E njëjta situatë shfaqet edhe për biznesin lokal i cili, me përjashtim të disa rasteve, kryesisht ka humbur deri diku interesin për t'u përfshirë në iniciativa lokale me karakter humanitar e social.

A përfshihen interesat e shoqërisë civile të zonës suaj në planet e pushtetit vendor?

Aktualisht edhe ato pak organizata që funksionojnë janë të pastrukturuara, me staf të lëvizshëm e shpesh të patrajnuar dhe nuk përfaqësojnë gjithë problematikën e grupeve të marginalizuara. Nga ana tjetër edhe pushteti lokal nuk i ka

dhënë rëndësinë e duhur nevojave të komunitetit për t'u organizuar në OJF me qëllim prezantimin dhe zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohet dhe që janë përgjegjësi e pushtetit vendor. Zakonisht OJF-të janë përfshirë në pushtetin lokal në rast të zbatimit të projekteve të ndryshme, ose kur ka qenë kërkesë e donatorit.

Me strategjinë e re që po hartohet në bashkëpunim me PNUD-in, është paraparë një rol më i madh i shoqërisë civile, biznesit, grupeve të interesit dhe përfaqësuesve të komuniteteve të ndryshme.

Cili do të ishte për ju një model për nxitjen e tri-partitetit: pushteti vendor – shoqëri civile - biznesi ?

Një bashkëpunim i suksesshëm në tri-partitet në qarkun e Beratit, ka qenë projekti i "Qendrës Ditore" në mbështetje të integritit të moshës së tretë mbi përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre; projekt i zbatuar nga dega e Kryqit të Kuq - Berat, me mbështetjen e pushtetit lokal. Aktivitete të tjera që mund të çojnë në thellimin e bashkëpunimit midis palëve mund jenë gjithashtu organizimi i një forumi vjetor ku të përfshihen OJF-të, pushteti vendor, biznesi dhe komuniteti etj. Një tjetër instrument mund të jetë hartimi i një strategjie bashkëpunimi, për çështje specifike si psh: mbështetja për të pastrehët, promovimi i turizmit, mbështetja e komunitetit rom, integrimi i moshës së tretë etj.

Brenda këtyre partnershipeve trepalëshe, cili është roli specifik për pushtetin vendor?

Evidentimi i nevojave të komunitetit dhe jo thjesht e një organizate të caktuar, përcaktimi i prioriteteve të zhvillimit dhe bashkëveprimit midis palëve, planifikimi i buxhetit përkatës për financimin e shërbimeve që lidhen me këto nevoja. Gjithashtu zgjedhja dhe përfshirja e OJF-ve dhe e biznesit lokal në këtë partnership, është përgjegjësi e pushtetit vendor, duke krijuar kushte për një bashkëpunim të favorshëm, të besueshëm dhe me rezultate konkrete në të mirë të komunitetit.

2. Antigonea një "Europë e vogël" brenda Europës së madhe – nga Ylli Muho, Kryetar i komunës Antigone, Gjirokastrë.

Trashëgimia kulturore në shërbim të zhvillimit ekonomik e social në Komunën Antigone, projekt që la gjurmë progresi e vazhdimësie

Duke u bërë partner dhe pjesë e iniciativës së Qendrës Kulturore Mediatike Antigone, e cila nëpërmjet projektit të saj "Trashëgimia kulturore në shërbim të edukimit, zhvillimit ekonomik e social në Komunën Antigone", në emër të stafit drejtues të komunës Antigone së pari do të doja të falënderoja njëkohësisht stafet e QKMA, programit ECSRA, UNDP dhe IDM që më në fund u fokusuan me projektet e tyre në zonat e largëta dhe rurale dhe aq më tepër me një sfidë të tillë si program "Fuqizimi i Shoqërisë civile në zonat rurale në Shqipëri". Më duhet të theksoj se programe të tilla janë me vlera të jashtëzakonshme për të zgjuar komunitetet e mbuluara nga apatia dhe varfëria, por jo nga vlerat njerëzore, traditat dhe vlerat e trashëgimisë kulturore.

Pasuritë dhe resurset më të çmuara të komunitetit të banorëve në komunën e Atigonesë janë të jashtëzakonshme, nisur nga përbërja etnokulturore e ndryshueshme. Në komunën tonë jetojnë bashkërisht: shqiptarë të krishterë trashëgimtarë të drejtpërdrejtë e traditave të zonës etnografike të Lunxhërisë, shqiptarë lebër myslimanë kryesisht blegtorë të ardhur nga malësitë e Kurveleshit në vitet e para pas Çlirimit, popullsinë arumune ose vllahë, vendosur këtu rreth viteve 60, por edhe të tjerë më të pakët në numër si zagoritë, përmetarë, e minoritarë greke. Natyrisht këta janë një pasuri e madhe njerëzore dhe etnokulturore që me projekte të tilla ngacmohen dhe zgjohen. Kjo bashkëjetesë e larmishme etnokulturore në këtë komunë me emër të madh ka krijuar një model të përkryer marrëdhëniesh të shkëlqyera, aq sa në miniaturë ngjan paksa edhe me modelin e madh të bashkëjetesës së integruar europiane. Duke parë dhe vlerësuar këtë model e mentalitet të bashkëjetesës, se të mos e cilësojmë Antigonenë tonë një “Europë e vogël” brenda Europës së madhe!?

Tradicionalisht, vendasit, lebërit dhe vllahët i lidhin dy fenomene, e para, se kanë patur si bazë të ekzistencës dhe zhvillimit të tyre blegtorinë, mbarështimin e bagëtime të imëta dhe të trasha, shoqëruar me tradita e pasione të tjera si frutikultura, vreshtat, zgjojet e bletëve, tufa të vogla pularie dhe e dyta, sepse komunitetet nga ata kanë prejardhjen kanë patur traditë emigracionin dhe lëvizjen demografike.

Nëse këtyre dy fenomeneve lidhëse do t’u shtonim edhe zakone, tradita, “tabjate” dhe vlera të tjera të përbashkëta, sikurse janë prodhimet artizanale si përpunimi i leshit, furka dhe tezgjahu, bujaria dhe mikpritja, bukuritë që u ka falur natyra dhe Perëndia, dhe nëse të gjitha këto i vendosim në sfondin e pasurisë më të madhe të zonës, trashëgimisë së lashtë të Antigonesë antike, atëherë pse të mos pretendojë ky komunitet i mrekullueshëm të jetojë me të ardhura të krijuara nga turizmi.

Provat e para të këtij orientimi janë dhënë, tufa të mëdha e të vogla me dhen, me dhi e me lopë, vreshta dhe shtëpi të reja, dy tri shtëpi janë kthyer në pritëse të turistëve të huaj, disa ndërmarrje të vogla, baxho të përpunimit të qumështit, një punishte artizanale e përpunimit të leshit, një furrë e re buke, një impiant i prodhimit të kërmillit, nesër edhe më shumë. Natyrisht, nën drejtimin e komunës, ky kondicion ekonomik i përshtatshëm për zhvillimin e turizmit kulturor, ekoturizmit, turizmit malor, turizmit aventuror, sporteve malore, hipizmit, alpinizmit, etj, do të mbështetet dhe inkurajohet për t’u bërë mënyrës tradicionale punës dhe jetesës.

Komuna Antigone është e përbërë nga 5-fshatra: Asim Zeneli, Arshi Lengo, Sarqinisht, Krinë, Tranoshishtë ka potenciale të mëdha. Ajo ka rreth 2.500 banorë, me një moshë relativisht të re (35 vjeç), me një numër rreth 400 familje. Sipërfaqja e përgjithshme e komunës 2800 ha, nga e cila tokë e kultivuar është 771 ha, kullota 1 739 ha, pyje 180 ha etj. Krejt i veçantë është fakti që numri i frymëve dhe familjeve ka shënuar rritje edhe pas viteve 90’, ndryshe nga zona të tjera të përfshira nga eksodi galopant. Mbi të gjitha rruga e re automobilistike Gjirokastër – Parku Arkeologjik Antigone i përshkon me asfalt të 5 fshatrat e komunës. Afërsia me qytetin e Gjirokastrës (vetëm 3 km nga fshati Arshi Lengo) bën të mundur që

prodhimet e tona bujqësore dhe blegtorale të kapin shumë shpejt tregun. Të gjitha fshatrat janë arsimdashëse, duke nxjerrë në vite rreth 250 specialistë të lartë nga të të gjitha fushat e shkencës dhe kulturë.

Me këtë rast, krahas falënderimeve pafund për zyrën e organizatës ndërkombëtare PNUD – Shqipëri, zyrën e Projektit ECSRA, Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe organizatën e shoqërisë civile Qendrës Kulturore Mediatike Antigones për realizimin e këtij projekti që la gjurmë progresi e vazhdimësie.

I ftoj të gjithë këta partner të ndërtuar që të forcojmë më tej bashkëpunimin për projekte më të plota në të ardhmen.



PARTNERË PËR NDRYSHIM: INICIATIVAT E PËRBASHKËTA ECSRA DHE OSHC TË ZONAVE RURALE/PERIFERIKE

4.1 Kuadri i nismave të përbashkëta

Gjatë “Panairit të ideve” rreth 40 organizata të shoqërisë civile prezantuan idetë dhe nismat e tyre për t’i zbatuar në zonat periferike dhe rurale të qarqeve: Lezhë, Elbasan, Berat dhe Gjirokastrë. Nëpërmjet këtij panairi u mundësua përzgjedhja dhe mbështetja financiare në formën e granteve të vogla të nismave të njëzetë OJF-ve gjatë periudhës gusht – nëntor 2012. Nismat adresojnë një sërë problematikash të komunitetit në zonat rurale dhe periferike në qarqet respektive.

Përzgjedhja e nismave u bë duke pasur parasysh objektivat e përgjithshme të projektit ECSRA si ndërtimin e kapaciteteve të organizatave vendore të shoqërisë civile dhe zhvillimin e prioriteteve në rajonet që ato operojnë. Kriteret që u morën në konsideratë gjatë vlerësimit të nismave të prezantuara gjatë “Panairit të ideve” ishin adresimi i problematikave reale për komunitetin lokal, zbatimi dhe shtrirja e aktiviteteve në zonat rurale dhe periferike të qarqeve përkatëse, komponenti i partneritetit me organet e qeverisjes lokale apo komunitetin e biznesit, etj.

Shumica e nismave përqëndroheshin në fushata informimi dhe ndërgjegjësimi për mbrojtjen e mjedisit, barazinë gjinore dhe rritjen e pjesëmarrjes së grave dhe komunitetit në përgjithësi në qeverisjen vendore si dhe ngritjen e kapaciteteve të OJQ-ve rurale. Gjithashtu nuk kanë munguar nismat të cilat kanë në fokus nevojat e grupeve vulnerabël si: komuniteti rom, të rinjtë në zonat rurale dhe inkurajimi i harmonisë ndërmjet grupeve minoritare. Krahas kësaj, disa prej iniciativave kishin për qëllim nxitjen e biznesit rural dhe ndikimin e politikave për zhvillimin bujqësor.

Kështu, nismat e mbështetura në kuadër të ECSRA përfshijnë:

- Qendra e Informacionit Aarhus – Vlorë – “Eko-Klubet Rinore – një iniciativë për mbrojtjen e mjedisit”.
- Qendra Kulturore Mediatike Antigonea (QKMA) - Trashëgimia kulturore në shërbim të edukimit, zhvillimit ekonomik e social në Komunën Antigone.

- Qendra për Menaxhimin Agro-Mjedisor dhe ekonomik (AEEM) – Monitorimi e vlerësimi i politikës së mbështetjes direkte të zhvillimit bujqësor në qarkun e Lezhës.
- Qendra Mjedisore për Mbrojtje, Edukim dhe Rehabilitim – EPER Center – “Skrapari, i pastër dhe i shëndetshëm”.
- Forumi Gruas Elbasan – “Të rritim pjesmarrjen e komunitetit në mirëqeverisjen vendore nëpërmjet ndërgjegjësimit të tyre për këtë të drejtë”.
- Shoqata “Gruaja Ndryshe” Librazhd - Gruaja dhe roli i saj në promovimin e vlerave dhe trashëgimisë kulturore.
- Projekti Ndërkombëtar i Mëshqerrave (PNM) – Ngritja e rritjes së shoqatave të fermerëve të komunave Karine, Përparim, Sinballaj, Gjoçaj dhe Pajovë në Qarkun e Elbasanit krijojnë kapacitetet për zhvillimin e qëndrueshëm të biznesit të vogël rural/familjar dhe përmirësimin e mjedisit.
- Mbrojtja e të drejtave të grave qytetare dhe fshatare – Forcimi i kapaciteteve të OJQ-ve rurale dhe institucioneve të qeverisë lokale në Berat, në mënyrë që të përmirësojnë shërbimet e ofruara për komunitetin.
- Seksioni Ndërkombëtar Shqiptar (CIOFF) – Inkurajimi i harmonisë dhe dialogut mes komunitetit majoritar dhe pakicave kulturore, minoritetit dhe grupeve etnike.
- Shoqata “ Në dobi të gruas shqiptare” Dega Elbasan - “Të rinjtë janë aktorë, partnerë edhe prijësit kryesorë të transformimit shoqëror të një vendi në zhvillim”.
- “Romët e Veriut” - Pasqyrimi i situatës konkrete të komunitetit Rom mbi dekadën Rome.
- Qendra “Shërbimet Bujqësore Elbasan” Sh.B.E –“Sensibilizim për ngritje kapacitetesh për pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje dhe formimi profesional i tyre në Komunitat Shirgjan, Belësh dhe Gostimë – Elbasan”.
- Shoqata e burimeve natyrore të komunës Gjinar – Turizmi dhe tradita të ndërthurura për një zhvillim të qëndrueshëm.
- Shoqata “Ndihmë sociale gruas kryefamiljare” –Barazia Gjinore: Një e drejtë themelore!
- Shoqata “Tjetër Vizion” - Nxitja e praktikave të mira mes Klubeve të Grave në komunat Gjergjan, Gostimë dhe Shushicë me qëllim përmirësimin e pjesëmarrjes së grave që jetojnë në zonat rurale në qeverisjen dhe zhvillimin vendor
- Shoqata “Jetimët në Fokus” - “Ngritja e strukturave të shoqatës si dhe rritja e kapaciteteve drejtuese të tyre në bashki dhe komuna të qarkut Berat”
- Shoqata “Gruaja Vizioni i Ndryshimit” - Rritja e aksesit të gruas në procesin vendimmarrës.
- Komiteti Rinor Lezhë - Rinia agjente për ndryshim dhe zhvillim.
- Shpresë për të varfrit - “Edhe NE jemi pjesë e komunitetit qytetar”
- Organizata për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Gjirokastrës (GCDO) - Forumi i Partneritetit për Zhvillimin e Turizmit në Rajonin e Gjirokastrës

4.2 Aktivitetet e zbatuara dhe rezultatet e arritura:

Në përgjithësi, aktivitetet e zbatuara në kuadër të nismave të mbështetura nga ECSRA kishin për qëllim ndërgjegjësimin e komunitetit për një sërë çështjesh të rëndësishme. Në lidhje me këtë, aktivitetet përfshinin organizimin e tryezava të diskutimit ndërmjet përfaqësuesve të qeverisjes vendore dhe komunitetit, trajnime të ndryshme, studime të potencialit bujqësor të zonave në fokus të projektit, aksione mjedisore dhe organizimin e panairove për të arritur një impakt më të madh dhe gjithëpërfshirës në rajonet përkatëse. Duke pasur parasysh që granti i vënë në dispozicion ishte i kufizuar, OShC-të kishin parashikuar me efektivitet shpërndarjen e grantit si dhe në shumë raste kishin vendosur partneritet me aktorët lokalë të qeverisjes vendore apo biznese për të realizuar aktivitetet e tyre. Në vazhdim kemi një përmbledhje të nismave dhe aktiviteteve të OSHC-ve të mbështetura nga ECSRA.

1. Fondacioni "Gjirokastra" - Gjirokastër

Në Gjirokastër nga data 28 - 30 shtator 2012, u zhvillua Panairi VI Kombëtar i Trashëgimisë dhe Artizanatit. Si zakonisht panairi zhvillohet në pazarin e qytetit në fund të shtatorit, në ditët e trashëgimisë dhe organizohet nga Fondacioni "Gjirokastra" (ish GCDO) në bashkëpunim me institucione të tjera. Vizitorët u njohën me punime të 120 artizanëve nga e gjithë Shqipëria dhe Kosova. Panairi është aktiviteti më i madh në Shqipëri për artizanatin shqiptar që zhvillohet rregullisht dhe, i shoqëruar gjithnjë me veprimtari të tjera kushtuar trashëgimisë kulturore, është kthyer në një ngjarje të rëndësishme për qytetin.

Aktivitetet e tij përkuan me festimet për 100 vjetorin e Pavarësisë Kombëtare dhe, në këtë kuadër, u organizua dhe një ekspozitë e veçantë me produkte artizanale. Në ditën e dytë u hap pavijoni i gatimeve gjirokastrite që janë me emër në të gjithë vendin dhe dallohen për përdorimin e erëzave dhe barishteve. Gjatë Panairit u zhvillua një konkurs për përzgjedhjen e disa çmimeve speciale ku një juri e përbërë nga specialistë të huaj dhe vendas të trashëgimisë vlerësoi me çmime si: "Produkti më i mirë artizanal", "Produkti më i mirë kushtuar 100 Vjetorit të Pavarësisë Kombëtare", etj. Panairi përmbloodhi edhe disa veprimtari argëtuese.

Edhe në këtë edicion u zhvillua si zakonisht një tryezë e rrumbullakët për probleme të artizanatit, trashëgimisë dhe turizmit. Tema e këtij viti ishte "Përpjekjet e bashkërenduara për zhvillimin e produktit turistik në rajonin e Gjirokastrës, krijimi i një forumi aktiv për organizimin e panairove në të ardhmen".

Kjo tryezë e rrumbullakët u realizua në vazhdimësinë e aktiviteteve të projektit "Forum i Partneritetit për Zhvillimin e Turizmit në Rajonin e Gjirokastrës".

Ky projekt pati për qëllim të mundësojë partneritet midis sektorit privat, publik dhe atij civil për përmirësimin e ofertës turistike në rajonin e Gjirokastrës nëpërmjet krijimit të Forumit për Zhvillimin e Turizmit në Gjirokastër. Forumi hartoi një rezolutë drejtuar gjithë komunitetit vendas dhe zgjodhi kryesinë e tij, ndërsa u mbloodhën donacionet e para me të cilat synohet të botohet një kalendar i veprimtarive vjetore në krahinë, të krijohet një websajt për turizmin në rajon dhe të mbledhen

donacione të mëtejshme për Panairin e vitit të ardhshëm. Aktiviteti i forumit do të vazhdojë menjëherë në këto drejtime me komunitetet vendase.

2. AARHUS Vlorë

Nisma Eco-Clubet Rinore – një shembull për mbrojtjen e mjedisit kishte për qëllim ndërgjegjësimin e të rinjve dhe qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit. Grupi i synuar ishin rreth 600 të rinj dhe të reja, studentë e aktivistë mjedisorë të rrethit Përmet.

Aktivitetet e realizuara në kuadër të tij ishin:

A. Krijimi i 5 Eco-Clubeve Mjedisore me të rinj e të reja si dhe qytetarë aktiv, dashamirës të mjedisit.

Në çdo Eco – Club u përfshinë nga 30 deri në 40 të rinj. Interesant ishte procesi i përzgjedhjes së drejtuesit/ drejtueses së strukturës së Eco-Clubeve, që u krye nëpërmjet një procesi demokratik dhe votimi të fshehtë të 2 ose më shumë kandidaturave për këtë post. Kandidatët e propozuar shpalosen platformat dhe strategjitë e tyre për rolin që do të luanin gjatë periudhës 3 mujore që do ishin në krye, si dhe për vazhdimësinë e nismës.

B. Organizimi i aktiviteteve sensibilizuese

Studentë, të rinj, anëtarë të Eco-Clubeve dhe qytetarë e aktivistë, morën pjesë në aksione për pastrimin e territoreve pranë shkollave ose në lagje të qyteteve për sensibilizimin e qytetarëve dhe pushtetit lokal për mbrojtjen e mjedisit. Vetë anëtarët e Eco-Clubeve organizuan takime me pushtetin lokal për të përcaktuar vendin e përshtatshëm për zhvillimin e aktivitetit, bazuar në territorin dhe ambientin që kishte më shumë mbeturina dhe që gjithashtu ka vizibilitet më të madh për qytetarët dhe komunitetin. Nga ana e pushtetit lokal u siguruan mjetet e nevojshme për largimin e thasëve me mbeturina të grumbulluar nga studentët e Eco-Clubeve.

C. Organizimi i një aktiviteti sensibilizues me të rinj dhe aktivistë, nga të gjitha Eco-Clubet

Në përmblyllje të iniciativës, në qytetin e Përmetit u organizua një takim me pjesëmarrjen e anëtarëve të Eco-Clubeve nga çdo qytet, Përmeti, Këlcyra, Ballabani, Petrani dhe Piskova. Morën pjesë edhe përfaqësues nga pushteti lokal i çdo komune dhe bashkie. Në këtë takim u ra dakord që të krijohet rrjeti i Eco-Clubeve Përmet. Gjithashtu, nga të rinjtë e Eco – Clubeve, u hartuan plane pune konkrete për mbrojtjen e mjedisit, të cilat iu përcollën autoriteteve lokale në çdo komunë dhe bashki për ti patur parasysh gjatë hartimit të planeve të tyre lokale vjetore.

3. CIOFF, Gjirokastrë

IncKurajimi i diversitetit kulturor, promovimi i dialogut dhe harmonisë mes komuniteteve që jetojnë në vendin tonë ishte nisma që CIOFF Seksioni Shqiptar në qarkun e Gjirokastrës zbatoi në periudhën shtator- nëntor 2012, duke patur si aktorë kryesorë minoritetin grek dhe pakicat kulturore e grupet etnike që jetojnë në këtë hapësirë gjeografike. Projekti përgjithësoi përvojën pozitive disa vjeçare që evidentohet në qytetin e Përmetit. Kjo nismë bëri pjesë edhe të rinj të shkollave

të mesme pa asnjë dallim e paragjykim në organizimin e një konkursi eseistik me temë " Të ndryshëm por të barabartë ". Mbi 32 të rinj, promovuan humanizmin e tyre social dhe inkurajuan dialogun mes tyre

4. Shoqata "Gruaja Vizioni i Ndryshimit"

Me nismën "Rritja e pjesëmarrjes së grave në proceset vendim-marrëse" kishte si qëllim rritjen e bashkëpunimit ndërmjet komunitetit dhe organeve vendimmarrëse për një qeverisje demokratike dhe gjithpërfshirëse. Dy komunat e përzgjedhura ishin Komuna Kallmet dhe Komuna Kolsh në rrethin e Lezhës. Aktivitet e propozuara për realizimin e qëllimit ishin kryesisht në fushën e informimit mbi funksionimin e vendim-marrjes nga Këshilli i Komunës, mbështetja dhe nxitja e një bashkëpunimi të komunitetit të grave me përfaqësuesit e Këshillit të Komuës, si pjesa më e marginalizuar dhe më pak e përfshirë në hartimin e vendimmarrjes komunitare. Për të arritur një pjesëmarrje të mirë të grave, me ndihmën e personit të përzgjedhur nga grupi i synuar, janë realizuar disa takime individuale dhe në grupe të vogla me gratë e fshatrave të dy komunave të përzgjedhura. Më pas janë organizuar dy trajnime ne grup, një me gratë ku përveç informimit mbi çështjet gjinore është bërë edhe hartimi i disa propozimeve që kërkojnë ndërhyrjen e institucionit të Komunës. Trajnimi i dytë ka qenë i përbashkët mes grave dhe përfaqësuesve të këshillit të komunës ku ndër të tjera është diskutuar edhe mbi zbatueshmërinë e këtyre propozimeve.

Çështjet e ngritura nga gratë ishin mjaft konkrete dhe të rëndësishme për jetën komunitare. Në diskutimet e bëra u vu theksi mbi nevojën emergjente të përfshirjes së komunitetit në hartimin e strategjive lokale dhe në buxhetimin vjetor pasi vetëm në atë mënyrë mund të garantohet një shpërndarje e drejtë dhe gjithpërfshirëse e shërbimeve dhe investimeve që ndërmerren. Përfaqësuesit e këshillit për disa prej çështjeve dhanë një përgjigje pozitive të menjëhershme dhe për të tjerat u impenjuan që t'i paraqesin në projekt-buxhetin e ardhshëm.

5. Shoqata "Mbrotja e të drejtave të Grave Qytetare dhe Fshatare", Berat

Qëllimi i kësaj nisme është forcimi i kapaciteteve të OJQ-ve rurale dhe institucioneve të qeverisë lokale në Berat, në mënyrë që të përmirësojnë shërbimet e ofruara për komunitetin. Gjatë muajit të parë të realizimit të nismës janë realizuar takime me shoqatat joqeveritare që veprojnë në rajonin e Beratit dhe përfaqësues të qeverisjes vendore në qarkun e Beratit. Këto takime kanë pasur si qëllim prezantimin e nismës dhe përcaktimin e pjesëmarrësve që do të përfitojnë nga paketa e trajnimeve. Gjatë këtyre takimeve u realizua një prezantim i shkurtër i tematikave që do të trajtohen gjatë trajnimeve dhe aktiviteteve të tjera që do të organizohen në kuadër të këtij projekti. Për të realizuar qëllimin e nismës u realizuan organizuan trajnime me OJQ-të rurale që veprojnë në qarkun e Beratit dhe me strukturat e qeverisë lokale. Temat e trajnimeve të zhvilluara përfshinin: 1. Zhvillimi organizativ dhe Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe 2. Menaxhimi i projekteve

Implementimi i kësaj nisme ishte një investim në zhvillimin institucional, leadership-in, menaxhimin e projekteve dhe të programeve si dhe ndërtimin e rrjeteve dhe

partneriteteve, të cilat edhe në përfundim të nismës do të ndihmojnë në krijimin e një qëndrueshmërie institucionale.

6. Shoqata e Burimeve Natyrore të Komunës Gjinar (SHBN)

SHBN ndërmori një nismë me titull "Turizmi dhe tradita të ndërthurura për një zhvillim të qëndrueshëm". Kjo nismë kishte për qëllim nxitjen e banorëve të kësaj komune për të qenë sa më aktiv në shpалosjen e vlerave natyrore dhe tradicionale të kësaj pike turistike. Ajo përfshinte të gjithë banorët e kësaj komune të të gjitha moshave nga brezi i ri deri tek moshë e tretë. Nisma përfshiu banorët e komunës me qëllim aktivizimin e tyre për t'u bërë pjesë e vendim-marrjes, për të shpалosur traditat, për të dhënë mendime për zhvillimin e turizmit në Gjinar. Çdo aktivitet ka përfunduar me një diskutim nga pjesëmarrësit se si mund të arrijmë një zhvillim të mirë të turizmit dhe shpалosje të traditave në formën e një zhvillimi të qëndrueshëm.

Aktivitete të tjera që pasuan në kuadër të zbatimit të nismës, ishin guida natyrore nëpër natyrën që të ofron Gjinari turistik, takime nëpër fshatra, fushata ndërgjegjësimi, pastrim mjedisi, takime e trajnime të nxënësve nëpër shkollat e mesme dhe nëntëvjeçare të komunës me synim përgatitjen e tyre për të qenë të aftë që të bëjnë vetë një fushatë dhe një takim përmbyllës ku u realizua edhe një analizë e të gjithë aktiviteteve të zhvilluara.

7. "Forumi i Gruas" Elbasan

Nisma rajonale "Forcimi i kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile në Zonat Rurale dhe Periferike" u shtri në qytetin e Elbasanit ku organizata "Forumi i Gruas" përfundoi ciklin e aktiviteteve të parashikuara në kuadër të nismës "Nxit pjesëmarrjen e komunitetit në mirëqeverisjen vendore nëpërmjet ndërgjegjësim-it të tyre për këtë të drejtë". Fokus grupi me temë: "Shërbimet sociale, kushtet shëndetësore dhe arsimit" u zhvillua në komunën Shushicë të rrethit të Elbasanit. Objektivi i këtij aktiviteti ishte informimi i komunitetit rreth situatës së shërbimeve sociale, shëndetësore dhe arsimore, rritjes së transparencës nga ana e ofruesve të shërbimeve si dhe marrjen e angazhimeve të përgjegjshme të këtyre ofruesve të shërbimeve për ti dhënë zgjidhje problemeve.

Takimi synonte të nxiste qytetarinë aktive dhe përmirësimin e qeverisjes në nivel vendor. Takimi nisi me kuptimin e disa termave rreth ndihmës ekonomike, legjisla-cionin përkatës, e më pas me prezantimin e pyetjeve të hartuara në kuadër të këtij fokus grupi duke u përqëndruar në kushtet sociale si ndihma ekonomike, transpor-ti, trajtimi shëndetësor, shkollimi; si dhe çështje të tjera aktuale mjaft shqetësuese siç ishte dhuna në familje. Mbas takimit disa prej pjesëmarrësve kërkuan ndihmë për problemet e tyre ose të të afërmeve, meqënëse u njohën me shërbimet e FGE-së. Sipas organizatorëve takimi kaloi në një frymë mjaft të hapur bashkëpunimi dhe ballafaqimi i komunitetit me përfaqësuesit e institucioneve lokale do të ndikon-te ndjeshëm në zgjidhjen e problemeve të tyre.

8. Shoqata "Gruaja Ndryshe" - Librazhd

Në kuadër të projektit ECSRA, shoqata "Gruaja Ndryshe - Librazhd" zbatoi aktivitetet e saj lidhur me vlerat e trashëgimisë kulturore në zonën e Librazhdit nëpërmjet organizimit të "Panairit të Vlerave dhe Trashëgimisë Kulturore". Paraprakisht u zhvilluan disa takime me pjesëmarrjen e grave dhe vajzave të zonës. Ky takim hapi serinë e aktiviteteve të shoqatës "Gruaja Ndryshe" ku pjesëmarrësit u njohën me nismën dhe diskutuan në grup për mënyrën e zbatimit të tij. Takimi i dytë, u fokusua në analizën dhe verifikimin e ecurisë së organizimit të panairit si detyrat e marra nga gratë dhe përfaqësues të komuniteteve lokale, vështirësitë që ato kishin dhe mënyrat për t'i kaluar këto pengesa. Takime të tjera janë zhvilluar në grupe të vogla në fshatra ku gratë banojnë për të parë nga afër si ato organizohen dhe bashkëpunojnë me njëra tjetrën. "Panairi i Vlerave dhe Trashëgimisë Kulturore" u realizua në 22 Shtator 2012, në Librazhd, me pjesëmarrjen e gjerë të grave dhe vajzave të zonës, të cilat prezantuan punimet e dorës dhe gatimet e zonës për të ftuarit. Një punë të mirë kishin bërë dhe gratë e komunitetit egjyptian me prezantimin e punëve të tyre të dorës. Në panair morën pjesë figura të ndryshme dhe shoqata të cilat punojnë në Librazhd me këtë fushë.

Qëllimi i këtyre aktiviteteve është jo vetëm përcjellja e vlerave kulturore tek komunitetet lokale, por dhe një sensibilizim për gratë e zonave rurale për të kuptuar më mirë rolin e tyre në jetën social-kulturore dhe zhvilluar kapacitetet e tyre në zhvillimin e zonës. Ndërkohë për pjesëmarrësit, aktiviteti kishte edhe vlera materiale, pasi produktet e prodhimet e tyre u shitën duke i nxitur ide biznesi për të ardhmen. Një ndër synimet e aktiviteteve të zhvilluara ishte që në këtë projekt gratë të ndjeheshin të barabarta dhe pa paragjykime dhe të ishin mbështetëse për iniciativat që ato vetë do të ndërmerrnin. Takimet u karakterizuan nga mirëkuptimi dhe marrëdhëniet e mira mes pjesëmarrësve, të cilët ndanë njohuritë dhe eksperiencat e tyre si dhe krijuan ura bashkëpunimi për të ardhmen.

9. Shoqata "Ndihmë Sociale Gruas Kryefamiljare" Kuçovë

Shoqata "Ndihmë Sociale Gruas Kryefamiljare" me qendër në Kuçovë, zhvilloi një sërë takimesh me të rinj e të reja të moshave të ndryshme mbi 16 vjeç, për t'i njohur ata me iniciativat e kësaj nisme, benefitet dhe objektivat finalë. Gjatë takimeve njohëse u përzgjedhën rreth 30 të rinj, të cilët u caktuan edhe si 'mbështetësit' për vazhdimësinë e projektit. Në këtë fazë u veçuan ata të rinj me aftësi lidhëse në grupet e tyre shoqërore. Pas mbledhjes së materialeve, organizimit të trajnimeve dhe materialeve promovuese nisën aktivitetet në terren për sensibilizimin e të rinjve për të përmirësuar sjelljen e tyre në lidhje me barazinë gjinore.

Disa qindra fletushka me informacion ndërgjegjësues u shpërndanë tek banorët ku promovohet nxitja e barazisë gjinore. Një pyetësor që trajtonte çështjet kyçe të barazisë gjinore në qytetin e Kuçovës iu shpërnda komunitetit me synim analizimin dhe vlerësimin e situatës në terren. Aktivitetet promovuese vazhduan me rreth 30 të rinj e të reja të veshur me bluzat e kapele të stampuara me sloganin e projektit të cilët shpërndanë materiale ndërgjegjësuese. Ata u trajnuan edhe në

raport me përmirësimin e mënyrës së sjelljes së të rinjve në lidhje me barazinë gjinore.

10. Shoqata “Tjetër Vizion”, Elbasan

Nisma kishte në fokus nxitjen e praktikave të mira mes ‘Klubeve të Grave’ në komunat Gjergjan, Gostimë dhe Shushicë me qëllim përmirësimin e pjesëmarrjes së grave që jetojnë në zonat rurale në qeverisjen dhe zhvillimin vendor. Objektivat specifike përfshinin:

- Promovimin e mekanizmave të bashkëpunimit dhe dialogut mes ‘Klubeve të Grave’ në komunat Gjergjan, Gostimë dhe Shushicë, institucioneve dhe komunitetit në zonat rurale.
- Ndërtimit të kapacitete dhe nxitjes së iniciativave në rrjet, nëpërmjet shkëmbimit të praktikave më të mira dhe trajnimeve.

Aktivitetet në kuadër të kësaj nisme ishin një takim koordinues mes ‘Klubeve të Grave’ të komunave Gjergjan, Gostimë dhe Shushicë, i cili shërbeu si urë lidhëse midis anëtarëve të këtyre Klubeve duke i bërë më pjesëmarrëse dhe kritike në lidhje me analizën e situatës së tyre (me një pjesëmarrje prej 54 grash). Gjithashtu u zhvilluan tre trajnime me ‘Klubeve të Grave’ sipas tematikave në vijim:

- “Diskriminimi – këndvështrimi social dhe ligjor i këtij fenomeni me fokus gratë”;
- “Të drejtat e njeriut me fokus gruan , roli aktual i gruas në zonat rurale”;
- “Buxhetimi me pjesëmarrje në komunat Gjergjan, Gostimë dhe Shushicë”.

Në kuadër të kësaj nisme u zhvillua edhe Panairi i ideve me pjesëmarrjen e anëtarëve të Klubeve të Grave, rreth 60 gra. Takimi funksionoi si inkubator idesh dhe veprimesh për mbrojtjen dhe respektimin e dinjitetit dhe rolin e grave, duke stimuluar një mjedis miqësor të shoqërisë civile në zonat rurale. Tematikat mbi të cilat u ngrit ky panair ishin:

- Si do të mund të ndikohet në lidhje me reduktimin e diskriminimit/përjashtimit me bazë gjinor në nivel qarku;
- Çfarë veprimesh konkrete mund të ndërmerren për përmirësimin e situatës me fokus pjesëmarrjen e grave në procesin vendim-marrës;
- Si do të mund të zbatohet ideja e një “Buxhetimi me Pjesëmarrje” në nivel komunash.

11. Qendra për menaxhimin agro-mjedisor & ekonomik (AEEM-CENTER) - Lezhë

Gjatë zbatimit të nismës “Monitorimi e vlerësimi i politikës së mbështetjes direkte të zhvillimit bujqësor në qarkun e Lezhës” fillimisht u zhvilluan disa takime me përfaqësues të 6 komunave ku shtrihej aktivitetet e parashikuara. Gjatë këtyre takimeve u grumbulluan të dhëna për sektorët e bujqësisë që janë mbështetur, numrin e granteve për secilën, sasia e parave apo sipërfaqja e mbjellë me to për

vitet 2007-2011. Në vazhdim, u prezantuan drejtimet kryesore të zhvillimit bujqësor dhe rural në qarkun e Lezhë dhe përparësitë e politikës së mbështetjes në këtë qark. Gjithashtu u prezantua metodologjia e nismës ndërmarrë nga AEEM-center në kuadër të ECSRA. Gjetjet që rezultuan nga monitorimi i ndërmarrë nga AEEM u ballafaquan dhe diskutuan me përfaqësues të Komunës përkatëse, të Drejtorisë së Bujqësisë, fermerëve të komunës dhe përfaqësuesve të AEEM-center. Gjatë këtij procesi dhe nisme fermerëve të zonës iu dha mundësia të shprehin shqetësimet e tyre për procesin, mangësitë që kanë hasur gjatë këtij procesi, dhe të propozojnë masa përmirësuese.

Një aktivitet tjetër që i shërbeu përmbushjes së objektivave të kësaj nisme ishte realizimi i intervistave me fermerë, rreth 20, gjithashtu u vizituan 2 fabrika përpunimi produkteve bujqësore të fermerëve të zonës, ku u njohëm me problematikën e tregtimit të produkteve bujqësore të përfshirë në skemat mbështetëse. Gjatë takimeve të hapura u prezantua metodologjia, rezultatet dhe u dhanë disa propozime e rekomandime për fermerët, për specialistët e bujqësisë dhe për politikëbërësit. Te gjitha të dhënat e grumbulluara gjatë këtij studimi janë pjesë e një raporti i cili do të jetë përveç të tjerave në dorën e politik-bërësve, të specialistëve të bujqësisë në rreth e komunë të cilët shpresojnë t'i marrin në konsideratë rezultatet e këtij studimi të pavarur.

12. Qendra “Shërbimet Bujqësore Elbasan” Sh.B.E. Elbasan

Nisma “Sensibilizime për ngritje kapacitetesh për pjesëmarrjen e grave në vendim-marrje dhe formimi profesional i tyre në Komunitat Shirgjan, Belësh dhe Gostimë – Elbasan” përkoi me nevojat që kishte target-grupi i zgjedhur dhe pati një ndikim pozitiv, evident. Ajo kombinoi një sërë tematikash dhe aktiviteteve për sensibilizimin e grave dhe burrave mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së grave në vendim-marrje dhe legjislativimin në fuqi, si dhe strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit për barazinë gjinore, të cilat në këto zona nuk ishin trajtuar më parë i dha të gjithë pjesëmarrësve informacionin e duhur.

Pjesa tjetër e seminareve u fokusua në tema profesionale si: cilësinë e qumështit, teknikën dhe higjienën e mjeljes dhe sëmundjet e gjirit në gjedhë, si dhe vjelja e ullinjve dhe kriteret e nevojshme për të përfituar vaj ulliri cilësor ndikuan pozitivisht sidomos në informimin e grave pjesëmarrëse, të cilat merren konkretisht me këto procese pune. Zonat ku u zhvilluan këto trajnime kanë një blegtori dhe ullishtari të zhvilluar dhe formimi i tyre me temat e mësipërme ka një ndikim direkt në përmirësimin e kryerjes së këtyre proceseve.

13. Shoqata “Jetimët në Fokus” Berat

Nisma mbi ngritjen e strukturave të shoqatës si dhe rritja e kapaciteteve drejtuese të tyre në Bashki dhe Komunitat e qarkut Berat” e ndërmarrë nga shoqata “Jetimët në fokus” Berat ishte rrjedhojë e nevojës për të mbështetur këtë kategori sociale të marginalizuar. Në përfundim të nismës u arrit ngritja e dy degëve të tjera të shoqatës në Poliçan dhe Çorovodë. Kjo ishte rezultat i një procesi të gjatë takimesh dhe konsultimesh me aktorët e qeverisjes lokale, organizatat e shoqërisë civile

dhe bizneset që mund të kontribuojnë në pajisjen e ambienteve të reja. Krahas kësaj, gjatë nismës u kushtua një vëmendje të vecantë disa aspekteve të tjera që lidhen drejtpërdrejt me rritjen e kapaciteteve të personave të përfshirë në strukturat e shoqatës. Kështu u organizuan disa seminare në lidhje me bazën ligjore të OJF-ve, të drejtat e fëmijëve jetimë, legjislacioni për mbrojtjen nga diskriminimi, aspektet financiare dhe aftësimi për ngritje fondesh.

14. EPER Center, Skrapar

Nisma "Skrapari, i Pastër dhe i Shëndetshëm" kishte si qëllim të përgjithshëm ndërgjegjësimin e komunitetit për pjesëmarrjen qytetare në mirëqeverisje dhe promovimin e vullnetarizmit. Konkretisht kjo nismë u shtri në bashkinë e Çorovodës duke adresuar çështjet e menaxhimit të mbetjeve nëpërmjet pjesëmarrjes qytetare dhe nxitjes së vullnetarizmit. Aktivitetet përfshijnë realizimin e tri trajnimeve për menaxhimin e mbetjeve me nënpunësit lokalë, si dhe sesione informimi për 3R (reduktim, ripërdorim, riciklim) dhe aksione pastrimi në disa shkolla 9-vjeçare. Një nga produktet e kësaj nisme ishte dhe përpilimi i një raporti në formën e një direktive "Menaxhimi i mbetjeve urbane në qytetin e Çorovodës" me prioritete dhe rekomandime për Bashkinë Çorovodës. Ky dokument u konsultua me përfaqësuesit lokalë dhe aktorë të tjerë të interesuar dhe gjeti mbështetje prej tyre.

15. Projekti Ndërkombëtar i Mëshqerrave (PNM), Elbasan

Në nismën që zbatoi Projekti Ndërkombëtar i Mëshqerrave (PNM) u mundësua ngritja e një Rrjeti të shoqatave të fermerëve të komunave Karinë, Përparim, Sinballaj, Gjocaj dhe Pajovë në Qarkun e Elbasanit. Ky rrjet do të mundësojë rritjen e kapaciteteve dhe aftësitë lobuese të fermerëve për zhvillimin e qendrueshëm të biznesit të vogël rural/familjar dhe përmirësimin e mjedisit të zonave respektive. Gjatë implementimit të nismës u krijuan premiset për një përmirësimin e bashkëpunimit të rrjetit të shoqatave lokale të fermerëve me pushtetin lokal dhe biznesin në përgjithësi. Kjo u arrit nëpërmjet një serie seminaresh me qëllim rritjen e kapaciteteve të rrjetit të fermerëve. Gjithashtu u realizua një fushatë ndërgjegjësuese për pastrimin dhe mbajtjen pastër të mjedisit. Në këtë fazë pati një pjesëmarrje dhe interes shumë të gjerë të komunitetit.

16. Shoqata "Në dobi të gruas shqiptare" Dega Elbasan

Shoqata implementoi një nismë me fokus të rinjtë në zonat rurale dhe ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me problemet e mprehta me të cilat ato ballafaqohen. Pas një serie seminaresh me të rinjtë e një komune në Elbasan mbi tema të tilla si: mbrojtja e të drejtave të njeriut, barazia gjinore, duhani dhe efektet negative të tij, sëmundjet seksualisht të transmetueshme (SST), dhuna në familje, mbrojtja e mjedisit dhe nxitja e vullnetarizmit. Në përfundim të ciklit të seminareve u realizua një aktivitet kulturor me të gjithë të rinjtë që morën pjesë në nismën "Të rinjtë janë aktorë, partner edhe prijësit kryesorë të transformimit shoqëror të një vendi në zhvillim". Një hap tjetër të rëndësishëm që u ndërmor gjatë nismës ishte krijimi i organizatës rinore pranë komunës ku u zbatuan aktivitetet e parashikuara. Kjo do të shërbejë në aktivizimin dhe organizimin e aktiviteteve në vazhdimësi me të rinjtë e zonës.

17. Shoqata Shpresë për të Varfërit - Lezhë

Shoqata e përqëndroi nismën “Edhe NE jemi pjesë e Komunitetit Qytetar” në zonat periferike të qytetit të Lezhës. Përfituesit kryesorë të kësaj iniciative ishin fëmijët dhe të rinjtë e komunitetit Egjiptian të zonës. Nisma kishte për qëllim pranimin dhe njohjen e të rinjve të Komunitetit Egjiptian si një hallkë kyce, e fortë dhe e qëndrueshme për zhvillim, lobim dhe advokaci . Gjithashtu rritja e përfaqësimit dhe integritit të tyre në shoqëri ishte ndër shqetësimet kryesore të nismës.

Kjo iniciativë filloi me një fushatë sensibilizuese dhe me vetë prezantimin e projektit në zonën periferike ku u operua dhe zbatuan aktivitetet. Gjatë hapit të parë u publikuan fletëpalosje me informacion të përgjithshëm mbi nismën si dhe u përgatitën posterat me qëllim ndërjegjësimin e fëmijëve dhe të rinjve të komunitetit egjiptian dhe komunitetit në tërësi. Në vazhdim u ndërmorën një cikël takimesh me to për të diskutuar mbi çështje që përbëjnë interes për këtë grup për të drejtat e njeriut, SST trajtimi dhe parandalimi i tyre, etj.

18. Komiteti Rinor Lezhë

Përfshiu në nismën e tij të rinjtë e 8 komunave të qarkut Lezhë. Nisma kishte për qëllim nxitjen e politikave dhe praktikave të mira në vendimmarrjen lokale midis të rinjve. Krahas shtrirjes së gjerë në këtë rajon iu kushtua një rëndësi e vecantë dhe përmbatjes së takimeve me të rinjtë. Gjatë tri muajve të zbatimit të nismës u organizuan takime të ndryshme ku u diskutuan tema të tilla si: pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje, rritja e aftësive drejtuese të të rinjve në komunat përkatëse, etj. Takimet u zhvilluan pranë ambienteve të komunave, ku morën pjesë dhe përfaqësuesit e komunave, nëpër shkolla dhe në zyrat e organizatës.

19. Shoqata Romët e Veriut, Lezhë

Duke pasur parasysh nevojën për të ndërhyrë në lidhje me problematikat me të cilat përballen Romët, shoqata zbatoi aktivitetet e saj në komunat e qarkut Lezhë me përqendrim më të madh të këtij minoriteti. Gjatë aktiviteteve të kësaj nisme u hartua një buletin ku përfshihej e gjithë problematika e evidentuar gjatë takimeve dhe intervistave të realizuara nga anëtarët e kësaj shoqate. Disa nga çështjet që u trajtuan dhe u ngritën nga pjesëmarrësit në takime ishin arsimi, punësimi, strehimi dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor.

20. Qendra Kulturore për Mbrojtjen e Antigonesë (QKMA), Gjirokastrë

Në fokus të nismës së mbështetur nga ECSRA kishte promovimin e vlerave kulturore të komunës Antigone dhe nxitjes së bizneseve lokale. Për këtë qëllim u përdorën mekanizma të ndryshëm si takime me përfaqësues të komunës dhe aktorë të interesuar për këtë zonë, publikimi i një gazete përgjatë gjithë kohëzgjatjesh së nismës, projektimi i dokumentarëve etj.

4.3 Rezultate

Në një vështrim të përgjithshëm është e vështirë të bëhet vlerësimi i ndikimit të këtyre nismave në kuadër të ECSRA-s. Megjithatë vlen të theksohet që këto nisma plotësuan dhe pasuruan më tepër të gjithë projektin si përsa i përket shtrirjes gjeografike ashtu edhe mbulimit të çështje dhe kategorive të ndryshme sociale, ndonëse granti i vënë në dispozicion ishte i vogël. Për një pjesë të OSHC-ve të mbështetura nga ECSRA impakti ishte më i dukshëm fill pas përfundimit të nismës. Ndërsa për disa të tjera kjo do të vijë me kalimin e kohës dhe me ndërhyrje të tjera nga këto organizata.

Për këtë, mund të përmendim disa raste ku impakti ka qenë i madh dhe ka mundësuar vazhdimësinë e nismave të tjera si në rastin e Fondacionit Gjirokastra. Nëpërmjet forumit për promovimin e turizmit në këtë zonë u bë e mundur krijimi i një fondi të veçantë – fund raising - me kontribute vullnetare të anëtarëve në forum, që do të përdoret veçanërisht për vazhdimësinë e aktiviteteve të tilla si Panairi i ardhshëm në qytetin e Gjirokastrës. Në këtë kuadër u hartua një rezolutë për mbështetjen e këtij forumi, u zgjodh kryesia e tij dhe u mblodhën donacionet e para nga grupi nismëtar i këtij forumi.

Në rastin e nismës së QKMA, kryetari i komunës ka vlerësuar rëndësinë e iniciativës së ndërmarrë nga kjo organizatë, po ashtu dhe komuniteti i biznesit në Gjirokastër ka dhënë mbështetjen e tij gjatë gjithë aktiviteteve të nismës së Fondacionit Gjirokastra. Gjithashtu, ngritja e strukturave pranë organeve të qeverisjes vendore për të promovuar interesat e grupeve të ndryshme sociale si jetimët në qarkun e Beratit, përbën një tjetër element që u përdor gjërësisht nga aktivitete e organizatave të mbështetura nga ECSRA.

Gjithashtu, në qarkun Lezhë brenda një kohe të shkurtër, gjatë këtyre nismave u bë e mundur përpilimi i një studimi dhe monitorimi të politikave të mbështetjes direkte të zhvillimit bujqësor. Gjetjet e këtij studimi u shpërndanë dhe diskutuan me të gjithë aktorët e interesuar dhe do të përbëjë një bazë për skemat e ardhshme të mbështetjes së fermerëve të asaj zone.

Duke pasur parasysh rëndësinë e problematikave që kanë prekur këto nisma duhet përmendur edhe elementi i partneritetit ndërmjet përfaqësuesve të qeverisjes vendore, organizatave të tjera lokale dhe komunitetit të biznesit. Në lidhje me këtë vihet re që të gjitha organizatatat i kanë kushtuar një rëndësi të veçantë qasjes së të gjithë aktorëve që mund të kontribuojnë në rritjen e ndikimit të nismave të tyre.

Në përfundim, megjithë kufizimet si kohore dhe materiale që kishin nismat e mbështetura nga ECSRA u bë e mundur që secila organizatë të përmbushë objektivat e parashikuara dhe të ndikojë në përmirësimin e gjendjes në fushat e ndërhyrjes. Gjithashtu ato rritën në tërësi numrin e çështjeve të trajtuara gjatë projektit ECSRA duke sjellë produkte të rëndësishme për komunitetin e zonave ku ato veprojnë.



ECSRA: PRAKTIKAT MË TË MIRA

5.1 Revista komunitare

“Revista Komunitare” jo rastësisht u përzgjedh që në fillimet e këtij programi, si zëri i iniciativës “Forcimi i Kapaciteteve të Shoqërisë Civile në Zonat Rurale dhe Periferike”. Revista Komunitare konsistonte në një botim periodik në kuadër të ESCRA-s duke u publikuar çdo tre muaj. Revista u kthye jo vetëm në një dritare komunikimi mes publikut dhe organizatave të shoqërisë civile, por në të njëjtën kohë u dha zë këtyre të fundit për të artikuluar dhe vënë në pah problemet dhe vështirësitë me të cilat ato përballen.

Rubrikat

Revista Komunitare, botimi periodik që shoqëroi implementimin e iniciativës ESCRA, u konceptua si një instrument komunikimi dhe informimi me aktorët e përfshirë dhe audiencat e interesuara mbi forcimin e shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike. Revista konsistonte në dhënie të një informacioni sa më të plotë mbi implementimin e këtij projekti, informacion i përgjithshëm mbi zhvillimin e shoqërisë civile në katër qarqet ku ECSRA u shtri, si dhe pasqyrimin e të gjitha aktiviteteve dhe produkteve të realizuara në kuadër të kësaj nisme.

Rubrikat kryesore në “Revistën Komunitare” u konceptuan në mënyrë të tillë që të mbulonin të gjitha aspektet e iniciativës duke u ndarë kronologjikisht: aktivitete të realizuara, aktivitete në vazhdim. Katër numrat e parë të Revistës përfshinë një informacion të përgjithshëm mbi situatën social – ekonomike dhe nivelin e aktivizimit të organizatave të shoqërisë civile në secilin qark.

Ndërkohë revista pati një fokus edhe më të gjerë se vet iniciativa ECSRA. Një pjesë të veçantë në revistë zinin edhe informacioni rreth projekteve dhe thirrjeve të ndryshme për aplikime të organizatave donatore. Kjo për t'i nxitur dhe dhënë mundësinë organizatave lokale të aplikojnë dhe vazhdojnë aktivitetet e tyre në zhvillimin e rajoneve rurale dhe periferike, edhe pas përfundimit të nismës ECSRA.

Rezultate

Revista Komunitare u botua në 6 numra me një tirazh prej 300 kopjesh / numër (1800 kopje në total) gjatë një periudhe 18 mujore që përkonte edhe me shtrirjen e ECSRA. Revista Komunitare u shpërnda gjatë aktiviteteve dhe iniciativave të ndërmarra në kudoër të ECSRA-s në të 4 qarqet: Elbasan, Gjirokastrë, Berat dhe Lezhë. Revista Komunitare gjatë 18 muajve të implementimit të nismës ECSRA përfshiu rreth 70 artikuj e raportime mbi aktivitete të ndryshme të zhvilluara në të katër qarqet. Në këtë kuadër u kontaktuan dhe u realizua një komunikim i ngushtë me organizatat lokale në të katër qarqet ku u shtri projekti. Një hapësirë e konsiderueshme iu kushtua edhe aktorëve të pushtetit vendor përmes intervistave me drejtues të lartë mbi arritjet dhe planet për të ardhmen, zhvillimin dhe partneritetin me shoqërinë civile në zonat e tyre respektive.

5.2 Panairi i Ideve

Panairi i Ideve ishte një gjetje origjinale dhe shumë efikase për realizimin e një prej qëllimeve kryesore të ECSRA – nxitjen e shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike. Ai u konceptua si një aktivitet që synonte të inkurajojë iniciativa konkrete nga aktorë të shoqërisë civile në këto zona për të promovuar një rol më aktiv të shoqërisë civile dhe një qytetari aktive në të mirë të komunitetit. Në këtë kuadër “Panairi i Ideve” inkurajoi iniciativa dhe ide nga organizatat joqeveritare



të bazuara ose me fokus kryesor në zonat rurale e periferike për të adresuar probleme konkrete dhe çështje relevante për komunitetin dhe qeverisjen në këto rajone, por edhe ftoi të merrnin pjesë aktorë të qeverisjes vendore, donatorë, përfaqësues të biznesit dhe mendjen për t'u njohur më shumë me shoqërinë civile të këtyre zonave dhe dhënë rrugë bashkëpunimeve të reja për të ardhmen.

Panairi i konceptua si një konkurs idesh dhe iniciativash inovative. Ai ishte i hapur për të gjitha organizatat joqeveritare, unione, shoqëri, grupe interesi nga rajoni i Beratit, Lezhës, Elbasanit dhe Gjirokastrës. Me dhjetra ide dhe iniciativa gjetën hapësirë për t'u prezantuar tek një grup ekspertësh që realizuan vlerësimin në fazën e parë të përzgjedhjes.

Në këtë event të organizuar nga IDM dhe PNUD si dhe në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile nga zonat rurale dhe periferike të qarqeve Lezhë, Elbasan, Berat dhe Gjirokastrë iu dha mundësi 40 organizatave joqeveritare për të prezantuar jo vetëm idetë e tyre në kuadër të ECSRA, por edhe idetë dhe iniciativat e tyre mbi projekte lokale në zonat periferike dhe rurale në përgjithësi. Ky aktivitet tërhoqi vëmendjen e mjaft donatorëve, përfaqësues nga institucionet ndërkombëtare dhe shoqëria civile, gjë që u dha mundësi organizatave pjesëmarrëse të krijonin edhe mundësi të tjera shtesë përtej kuadrit të ECSRA.

Me tej Panairi i lideve, u pasua nga prezantimet dhe takimet informuese mes përfaqësuesve të organizatave rurale me donatorët pjesëmarrës dhe përfaqësuesve nga shoqëria civile, me qëllim nxitjen e kontakteve të drejtpërdrejta e partneritetet me aktorë të tjerë institucionalë, të përfshirë në mbështetjen e sektorit civil në vend, si dhe krijimin e mundësive dhe urave të reja të bashkëpunimit në mbështetje të iniciativave të organizatave të shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike.

Rezultate

Në këtë panair më tepër se 100 përfaqësues nga organizata të ndryshme me fokus në zonat rurale dhe periferike ndanë idetë dhe pikëpamjet e tyre, mbi nis-ma konkrete të këtyre shoqatave në dobi të përmirësimit të jetës së komuniteteve në rajonet rurale dhe periferike në Shqipëri. Po kështu rreth 70 pjesëmarrës të tjerë, përfaqësues të pushtetit vendor, komunitetit të donatorëve dhe sektorit privat ndanë këndvështrimet e tyre, por edhe planet dhe mundësitë që ata ofronin për mbështetjen e shoqërisë civile në zona rurale dhe periferike.

Rreth 40 prej projekt-ideve të propozuara u përzgjedhën për të aplikuar në fazën e dytë për mbështetje konkrete përmes ECSRA. Në përzgjedhjen e tyre u ndoqën pikë së pari kriteret e vlerësimit të projekt-ideve të njohura më herët prej pjesëmarrësve. Përveç tyre, ekipi vlerësues u kujdes për një shpërndarje sa më të mirë të mundshme midis rajoneve si dhe tematikave/grupeve përfituese. Kështu u arrit të mbështeteshin të paktën 4 projekte për secilin rajon si dhe të mbuloheshin çështje të identifikuar si parësore gjatë fazës së vlerësimit të nevojave si më mëposhtë:

- Ndërgjegjësimi i komunitetit mbi qeverisjen gjithëpërfshirëse dhe promovimi i vullnetarizmit;

- Rritja e pjesmarrjes së grave në jetën komunitare e politik-bërje;
- Bashkëpunimi më i gjerë dhe krijimi i partnershipeve midis qytetarëve, sektorit privat dhe atij publik;
- Adresimi i problemeve sociale, shëndetësore, edukative në veçanti me fokus në grupet vulnerabël / të marxhinalizuara.

5.3 Mbështetja me grante e shoqërisë civile në zonat rurale dhe periferike

Për herë të parë IDM u përfshi në një iniciativë e cila përveç komponentëve të tjera që u përdorën me synim rivitalizimin e shoqërisë civile në zona rurale dhe periferike ofroi dhe mbështetje të drejtpërdrejte me grante të vogla. Alokimi i tyre u realizua përmes një procesi transparent të organizuar në disa faza në të cilat kontribuan të gjithë komponentët e përshkruar edhe në këtë botim.

Aktivitetet ndërgjegjësuese dhe ato për ndërtimin e kapaciteteve kontribuan në rritjen e numrit të aplikimeve, cilësinë e projekt-propozimeve dhe për pasojë edhe në numrin e përfituesve të granteve. Ndërkohë IDM, duke i konsideruar këto iniciativa lokale si iniciativa të përbashkëta të ECSRA dhe organizatave lokale, ofroi vazhdimisht mbështetje dhe udhëheqje për aplikantët dhe fituesit si gjatë procesit të aplikimit dhe përzgjedhjes ashtu edhe gjatë implementimit.

Nga ana tjetër, përmes aktiviteve monitoruese dhe vlerësuese IDM ndoqi nga afër dhe u kujdes për një zbatim rigoroz, cilësor dhe me impakt të konsiderueshëm të këtyre iniciativave. Falë kombinimit të këtyre komponentëve u arrit mbyllja në kohë dhe me sukses e të gjitha iniciativave.

Rezultate

Përmes ECSRA u mbështetën iniciativat e organizatave të mëposhtme sipas të katërt qarqeve ku i implementuan iniciativat.

Qarku Elbasan (7)

- “Heifer Albania”, Tiranë
- “Forum i Gruas”, Elbasan
- “Gruaja Ndryshe”, Librazhd
- “Në Dobi të Gruas Shqiptare”, Elbasan
- Qendra për “Shërbime Agrikulturore”, Elbasan
- “Burimet Natyrore”, Elbasan
- “Vizion Tjetër”, Elbasan

Qarku Lezhë (5)

- Gruaja Vizioni i Ndryshimit, Lezhë

- Komiteti Rinor, Lezhë
- Romët e Veriut, Lezhë
- Qendra për menaxhim ekonomik dhe agrikulor, Lezhë
- Shpresë për të Varfërit, Lezhë

Qarku Gjirokastrë (4)

- Qendra e informimit Aarhus, Vlorë
- Qendra kulturore dhe mediatike "Antigonea", Gjirokastrë
- CIOFF, Përmet
- GCDO, Gjirokastrë

Qarku Berat (4)

- EPER, Tiranë
- Mbrojtja e të drejtave të grave urbane dhe rurale, Berat
- Jetimët në Fokus, Berat
- Ndihmë sociale gruas kryefamiljare, Kucovë

20 organizata përfituan në mënyrë të drejtpërdrejte nga mbështetja financiare e ECSRA. Shtrirja e aktiviteteve të tyre përfshiu rreth 15 bashki dhe 45 komuna në të katërt qarqet. Variacioni i organizatave aplikuese dhe projekteve të tyre i diversifikoi edhe më tej arritjet dhe impaktin e ESCRA-s. Për një ide mbi diversitetin e iniciativave të mbështetura më poshtë po paraqesim vetëm disa prej tyre:

- Ndërtimi i një rrjeti fermerësh i iniciuar nga Heifer Albania duke filluar me përfshirjen fillestare të 5 komunave të qarkut të Elbasanit: Perparim, Gjocaj, Sinballaj, Pajovë dhe Gostimë.
- Themelimi i klubit të grave në komunat Gostimë, Shushicë dhe Gjergjan në qarkun e Elbasanit përmes iniciativës së organizatës "Tjetër Vizion".
- Krijimi i një grupi polifonik me përfaqësues nga grupet vulnerabël në komunat e qarkut Gjirokastrë nga organizata CIOFF.
- Ndërtimi i Eko-klubeve Rinore në pesë komuna të qarkut Gjirokastrë nga qendra informuese Aarhus;
- Krijimi i forumit për partneritet të shoqërisë civile në zonat rurale të qarkut Gjirokastrë GCDO,
- Vlerësimi i nevojave të komunitetit Rom në zonat periferike të Lezhës nga një organizatë e këtij komunitet – Romët e Veriut etj.